



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 1, datë 03.03.2005

PËR
KËRKESAT DHE PROCEDURAT E MIRATIMIT TË LEJEVE,
AUTORIZIMEVE DHE KONCESIONEVE PËR PËRDORIMIN E UJIT

Në mbështetje të neneve 6 dhe 18 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

- I. Deklarimet për përdorim të lirë të ujit, bëhen pranë Agjencive të Ujit të Baseneve Ujëmbledhëse, (shkurt Agjencia), në përputhje me formularin e miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU).
- II. Subjektet juridikë dhe fizikë, vendas apo të huaj paraqesin kërkesë për përdorim të ujit pranë Sekretariatit teknik të KKU-së (shkurt Sekretariati) ose Agjencisë, në përputhje me formularët e miratuar nga KKU.
- III. Kërkesat që paraqiten nga subjektet juridikë dhe fizikë (shkurt subjekte) për përdorim të ujit, janë për: leje, autorizime dhe koncesione.
 1. Kërkesat për leje dhe autorizime paraqiten në:
 - a) Agjenci, kur veprimtaria për të cilën kërkohet përdorimi i ujit parashikohet të kryhet brenda kufirit të basenit;
 - b) Sekretariat, kur veprimtaria parashikohet të kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm dhe në rastet kur veprimtaria është “lundrueshmëri” ose “ndërtim strukturash, ankoruese portuale”.

2. Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit, miratohen nga:
 - Këshilli i Basenit Ujëmbledhës (KBU), kur veprimtaria, për të cilën kërkohet përdorimi i ujit parashikohet të kryhet brenda kufirit të basenit.
 - KBU, kur veprimtaria parashikohet të kryhet jashtë kufirit të një baseni të vetëm, pasi më parë të jetë marrë mendimi nga Sekretariati.
 - KBU, kur veprimtaria, për të cilën kërkohet leja për përdorimin e ujit, është “lundrueshmëri” ose “ndërtim strukturash, ankoruese dhe portuale”.

3. Lejet dhe autorizimet për përdorimin e ujit jepen nga Autoritetet e Ujit sipas formularëve “B” (për leje) dhe “D” (për autorizime) të miratuar nga KBU-ja.
 - Lejet jepen për një afat 5 vjet duke u rinovuar çdo vit.
 - Autorizimet jepen për një afat deri 2 vjet. Kur studimi del me sukses dhe kushtet e autorizimit e parashikojnë këtë, i autorizuari ka të drejtë të paraqesë një kërkesë për leje ose koncesion brenda 6 muajve nga data e përfundimit të studimit.

4. Për ujin, që përdoret: për lokale të ushqimit social si restorante, bare, hotele, pishina; për rritjen e rasatit të peshkut; për stalla blegtorie; pulari; për lavazhe; përpunim mermeri; për nyjet e prodhimit të inerteve si dhe për procese teknologjike (tabela 3, bashkëlidhur), Autoritetet e Ujit japin leje, sipas formularit “B” të miratuar nga KBU-ja.

5. Kërkesat për përdorim me koncesion të ujit, në funksion të prurjes së kërkuar të ujit, do të paraqitet pranë Sekretariatit ose Agjencisë, sipas tabelave nr. 1, nr. 2 dhe nr. 4 që i bashkëlidhen këtij vendimi (kolonat 10 dhe 11).

6. Dhënia e konçesioneve për përdorimin e ujit, me përjashtim të rasteve të pikës V, të këtij vendimi, të bëhet me procedurë konkurimi, pas miratimit në parim nga KBU ose KBU.
 - Në rastet kur Autoriteti i Ujit vendos të japë për përdorim me koncesion ujin, shpall konkurs, duke kërkuar propozime nga subjekte të interesuara (propozim i kërkuar).
 - Në rastet kur pranë Autoritetit të Ujit paraqitet një kërkesë për përdorim uji (propozim i pakërkuar) Autoriteti i Ujit gjykon nëse uji do t'i nënshtrohet procedurës së konkurimit.

7. Sekretariati ose Agjencia paraqet për “shqyrtim” dhe “miratim, në parim” në mbledhjen e K KU-së ose KBU-së, mundësinë e dhënies në përdorim me koncesion të ujit, të kërkuar sipas pikës III/5 dhe III/6.
8. Për kërkesat që i drejtohen Sekretariatit, (sipas pikës III/1/b, dhe pikës III/5), para se të shqyrtohen për “miratim në parim”, paraprakisht, merret mendimi i KBU-ve përkatëse.
9. Përgatitja e dokumentacionit të konkursit dhe procedura e konkurimit, kryhen nga Sekretariati ose Agjencia.

IV. Procedurat e Konkursit për dhënien me koncesione.

A. Procedurat për propozimet e kërkuara

Kur K KU ose KBU, sipas planeve kombëtare ose të baseneve ujëmbledhëse për ujin ose studimeve të tjera specifike, arrin në përfundimin se një burim ujq mund të jepet për përdorim me koncesion, ai merr një vendim për përdorimin e ujit.

Sekretariati ose Agjencia përgatitin dhe ndjekin zhvillimin e procedurave të konkursit. Pas vlerësimit të propozimeve dhe miratimit të kësaj liste nga Autoritetet e Ujit (K KU ose KBU), Sekretariati ose Agjencia ndjekin procedurat për hartimin e projektkontratës.

1. Format e Konkursit

Për konkurim përdoren dy forma procedure:

a) Konkurs i hapur dhe b) Konkurs ndërkombëtar

a) Konkursi i hapur, do të përdoret për prurjet sipas rreshtave 1-3, të tabelës nr. 1 dhe rreshtave 1 - 2 të tabelës nr. 2.

b) Konkursi ndërkombëtar, do të përdoret për prurjet sipas rreshtave 4-5, të tabelës nr.1; rreshtit 3, të tabelës nr. 2 dhe rreshtave 1-2 të tabelës nr. 4 që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Përgatitja e Konkursit

2.1. Shpallja e konkursit do të bëhet nëpërmjet njoftimit në gazeta, për të mundësuar pjesëmarrjen e subjekteve të interesuara:

a. Për konkursin e hapur, në dy gazeta kombëtare;

- b. Për konkursin ndërkombëtar, në një gazetë të njohur ndërkombëtare, në një gazetë kombëtare dhe nëpërmjet medias elektronike, për të tërhequr një numër sa më të madh ofertash.

2.2. Subjektet do të paraqiten pranë Sekretariatit ose Agjencisë, ku do të marrin kërkesat e dokumentacionit standart që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në konkurs, si dhe sqarimet e nevojshme për plotësimin dhe afatet e dorëzimit të tyre. Dokumentacioni standart i konkursit miratohet nga KKU-ja dhe përbëhet nga:

2.2.1 Ftesa për ofertë, e cila përmban këto elementë:

- Procedurën e konkursit;
- Emrin e burimit ujq dhe tipin e tij;
- Vendndodhjen e burimit;
- Karakteristikat kryesore (prurja, kimizimi, etj) të burimit;
- Sasinë e ujit që jepet për përdorim;
- Qëllimet e përdorimit (pa e kufizuar të drejtën e personave për propozime të tjera);
- Ditën dhe orën e hapjes së ofertave;
- Afatin dhe çmimin e tërheqjes së dokumentave të konkursit pranë Sekretariatit ose Agjencisë përkatëse;
- Adresën e Sekretariatit ose Agjencisë pranë së cilës do të paraqiten të interesuarit.

2.2.2 Udhëzimi për pjesëmarrësit në konkurs, i cili do të përmbajë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e ofertave si dhe:

- Afatin e përgatitjes të propozimeve nga subjekti. Periudha ndërmjet afatit të tërheqjes së dokumentacionit të konkursit dhe të dorëzimit të propozimeve do të jetë:

- jo më shumë se 30 ditë, për konkursin e hapur;
- jo më shumë se 45 ditë, për konkursin ndërkombëtar.

- Kontratën tip me kusht, të miratuar nga KKU-ja.
- Kontratën tip të koncesionit, të miratuar nga KKU-ja.
- Specifikim termash për objektin për të cilin konkurohet (kur është e nevojshme, sipas rastit).
- Kërkesat për kualifikim (dokumentacioni juridik) të parashikuar në formularin "C", të miratuar nga KKU-ja.
- Dokumentacionin teknik dhe ekonomiko-financiar të parashikuar në formularin "C", të miratuar nga KKU-ja.

- Shpjegimin e pjesëve përbërëse të formularit të kërkesës dhe të plotësimit të tyre, etj.
- Vendimin nr. 313, datë 21.05.2004 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit”.

2.3. Pjesëmarrësi do të dorëzojë, në Sekretariat ose Agjenci, dokumentacionin që është në përputhje me udhëzimin për pjesëmarrjen në konkurs, i ndarë në 2 zarfa të veçantë, si vijon:

zarfi nr. 1 - Formulari i aplikimit dhe dokumentacioni juridik

zarfi nr. 2 - Dokumentacioni teknik dhe

- Dokumentacioni ekonomiko-financiar.

2.4. Përveç dokumentacionit të mësipërm Sekretariati ose Agjencia, kur e sheh të nevojshme, mund t`u kërkojë pjesëmarrësve në tender edhe dokumente ose të dhëna të tjera.

3. ZHVILLIMI I KONKURSIT

3.1. Dorëzimi i propozimeve dhe kualifikimi i pjesëmarrësve.

I gjithë dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet, në origjinale dhe/ose të noterizuara.

- Pjesëmarrësit në konkurs do të përdorin dokumentat standarte të konkursit, të përgatitura nga Sekretariati ose Agjencia. Nëse Sekretariati ose Agjencia sheh të domosdoshëm ndonjë ndryshim apo plotësim dokumentacioni, kjo duhet t`u komunikohet pjesëmarrësve, brenda një periudhe të mjaftueshme (jo më vonë se një e treta e ditëve për përgatitjen e dokumentacionit të propozimit) kohe për të kryer këto ndryshime ose plotësime, përpara afatit të dorëzimit të propozimeve.
- Hapja e ofertave do të bëhet nga komisioni (minimumi 5 vetë) i përbërë prej:

për Sekretariatit – nga punonjësit e Sekretariatit dhe specialistë të caktuar nga zëvendëskryetari i KKU-së;

për Agjencinë – nga punonjësit e Agjencisë dhe nga specialistë të caktuar nga kryetari i KBU-së (njëri prej specialistëve duhet të jetë Jurist).

Në ditën dhe orën e caktuar, Sekretariati ose Agjencia në prani të të gjitha përfaqësuesve të subjekteve, që kanë sjellë propozime shqyrton zarfin nr. 1, që përmban formularin e aplikimit dhe dokumentacionin juridik. Plotësimi i formularit të aplikimit dhe dokumentacionit juridik si dhe rregullsia e tyre do të shërbejnë si kusht për kualifikimin e

subjekteve. Subjektet, që kanë mangësi ose parregullsi në këto dokumente, s'kualifikohen nga konkursi.

3.2.Kriteret e vlerësimit të propozimeve

Sekretariati ose Agjencia, pasi shqyrton zarin nr. 2, i cili përmban dokumentacionin teknik dhe dokumentacionin ekonomik-financiar, bën vlerësimet në pikë të subjekteve si më poshtë:

	Maksimumi i mundshëm në pikë
a. Vlerësimi i dokumentacionit teknik	25
- Projekti i përdorimit të ujit	10
- Sasia më e vogël e përdorimit të ujit (l/sek)	10
- Cilësia e pajisjeve që do të përdoren	5
b. Vlerësimi i dokumentacionit ekonomik-financiar	75
- Tarifa më e lartë e pagesës, e propozuar nga konkuresi, për njësinë e ujit (<i>ku tarifa më e ulët është ajo sipas vendimit nr. 313, datë 21.05.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit"</i>).	28
- Periudha më e shkurtër e koncensionit	15
- Synimet e biznesit (rritja e gamës së prodhimeve, shtimi i tregjeve, etj)	5
- Periudha më e shpejtë për vënien në shfrytëzim të objektit dhe frytshmëria e tij.	10
- Përvoja në fushën e përdorimit të propozuar të ujit	5
- Mundësia financiare për investimin, besueshmëria e huasë.	3
- Niveli i plotësimit të kërkesave për ofertë	2
- Besueshmëria e ofertës (<i>mundësia reale për realizimin e ofertës së tarifës</i>).	7
Shuma (pika a + pika b)	100

Në çdo rast, subjekti kualifikohet nëse plotëson 75 pikë nga 100 të mundshme (përfshihen nga ky kusht koncesionet për hidroenergji dhe vaditje, deri në miratimin e tarifave përkatëse nga Këshilli i Ministrave).

3.3. Shpallja e listës së vlerësimit.

- Sekretariati ose Agjencia, mbas shqyrtimit të dokumentacionit teknik dhe ekonomiko-financiar, harton listën e vlerësimit të tyre sipas renditjes së pikëve. Kjo listë shpallet në vende të caktuara të Sekretariatit (në MRrTT) ose Agjencisë.

Procedura e mësipërme dhe vlerësimi në pikë zhvillohet edhe sikur të ketë një propozim të vetëm.

Nëse dy apo më shumë persona vlerësohen me pikë të barabarta, ka përparësi personi i cili ka kryer një studim të burimit ujor, në bazë të një autorizimi të dhënë nga autoritetet e ujit. Në rastet e tjera ka përparësi personi që ofron tarifën më të lartë të pagesës për përdorimin e ujit.

Subjektet pjesëmarrëse në konkurs, brenda 5 ditëve nga dita e shpalljes së listës së vlerësimit, kanë të drejtë të ankohen pranë titullarit të Sekretariatit kur konkursi zhvillohet nga Agjencia dhe pranë titullarit të ministrisë që mbulon fushën e ujit kur konkursi zhvillohet nga Sekretariati. Kundër vendimeve të përmendura më sipër, mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

3.4. Miratimi i fituesit

Sekretariati ose Agjencia, pasi kanë bërë klasifikimin e ofertave dhe pasi ka kaluar afati i ankesave nga subjektet pjesëmarrëse në konkurs, materialin përkatës, e paraqet për miratim në mbledhjen radhës së K KU-së ose KBU-së. K KU ose KBU vendos, shpalljen e fituesit të konkursit.

Sekretariati ose Agjencia ka për detyrë të mbajë procesverbalet e mbledhjes, të cilat, së bashku me dokumentacionin e konkursit, do të përfshihen në një dosje, me emërtimin e konkursit. Dosja ruhet pranë sekretariatit ose agjencisë në përputhje me ligjin "Për arkivat". Këto dokumenta vihen në dispozicion të organeve të autorizuara për kontroll apo verifikim.

Sekretariati ose Agjencia, brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit të K KU ose KBU të shpalljes së fituesit, njofton subjektin fitues të paraqitet për të nënshkruar një kontratë me kusht, për ecurinë e mëtejshme të procedurës për lidhjen e kontratës së koncesionit.

Për nënshkrimin e kontratës me kusht, personi fitues, brenda 10 ditëve nga marrja e njoftimit si fitues, duhet detyrimisht të paraqesë një garanci

bankare nga një bankë (ngurtësim i shumës 2 për qind të vlerës së investimit të parashikuar).

3.5.Kontrata me kusht

Kontrata me kusht është akt juridik, që nënshkruhet nga titullari i Sekretariatit ose Agjencisë dhe subjekti fitues. Ajo do të përmbajë, këto kushte:

- a. Objektin, pranimin e lidhjes së kontratës së koncesionit në përputhje me ofertën e paraqitur dhe kërkesat e parashikuara në dokumentacionin e konkursit;
- b. Afatin prej 3 muajsh të vlefshmërisë së kësaj kontrate me kusht deri në lidhjen e kontratës së koncesionit;
- c. Sipërmarrjen e subjektit që, brenda këtij afati të negociojë dhe të përfundojë kontratën tip të koncesionit, duke e dorëzuar së bashku me:
 - Vërtetimin e pronësisë (nga hipoteka apo kadastra) ose kontratë apo aktmarrëveshjen për blerjen ose marrjen me qira të truallit, ku do të investohet;
 - Vlerësimin e ndikimit në mjedis, aprovuar nga Ministria e Mjedisit;
 - Dokumentin e aftësisë profesionale për veprimtarinë e kërkuar.

Në rast se subjekti nuk e siguron dokumentin e pronësisë, për koncesione me interesa publike, subjekti duhet të bëjë një kërkesë pranë organeve kompetente për fillimin e procedurave të shpronësimit, në përputhje me dispozitat në fuqi. Në këtë rast shpenzimet do të mbulohen nga subjekti.

- Për subjektet juridikë të huaj, që shpallen fitues, kërkohet që të kryejnë procedurat përkatëse për regjistrimin si person juridik dhe si person i tatueshëm që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri.
- d. Kushtin që subjektit fitues i humbet e drejta e marrjes së koncesionit dhe i mbahet garancia bankare për sigurimin e lidhjes së kontratës me kusht, nëse brenda 3 muajve ai nuk plotëson detyrimet sipas kësaj kontrate me kusht dhe nëse për faj të tij nuk përfundohet projektkontrata e koncesionit, e pranueshme për të dyja palët. Në këtë rast, njoftohet të paraqitet për negociim personi i kualifikuar i dyti dhe nëse ai pranon përsëritet procedura, duke filluar nga nënshkrimi i kontratës me kusht. Në rast se personi nuk është më i interesuar, ftohet subjekti i klasifikuar i treti në listën e vlerësimit, e kështu me radhë.

Sekretariati ose Agjencia gjatë periudhës së negociimit të projektkontratës të koncesionit mund të kryejë kontrolle dhe sondazhe për besueshmërinë e të dhënave të paraqitura nga fituesi i tenderit.

3.6. Lidhja e kontratës së koncesionit

Kur pas negociimeve, ndërmjet Sekretariatit ose Agjencisë dhe subjektit arrihet në përfundimin se projektkontrata e koncesionit e paraqitur nga subjekti (pas ndryshimeve të mundshme, si rezultat i negociimeve) është e pranueshme për të dyja palët, ajo nënshkruhet nga titullari i Sekretariatit ose i Agjencisë dhe nga përfaqësuesi ligjor i subjektit.

Projektkontrata paraqitet nga Sekretariati ose Agjencia në mbledhjen e radhës të KKU-së ose KBU-së. Në këtë mbledhje KKU-ja ose KBU-ja merr vendim për miratimin ose jo të projektkontratës. Në rastin e mosmiratimit të projektkontratës së paraqitur, për korigjime apo plotësime të nevojshme, ajo i kthehet Sekretariatit ose Agjencisë për reflektimin e vërejtjeve (në negociim me subjektin). Pas korigjimeve (afati caktohet nga KKU-ja ose KBU-ja) projekti paraqitet përsëri për miratim në KKU ose KBU.

Për rastet kur miratimi është e drejtë e Këshillit të Ministrave, projektkontrata e miratuar nga KKU-ja i dërgohet, për miratim, Këshillit të Ministrave.

B. Procedurat për propozimet e pakërkuara

Kur pranë agjencisë a sekretariatit paraqitet një propozim i pakërkuar për përdorim të ujit, studiohen parametrat kryesorë të këtij burimi dhe impaktet e shfrytëzimit të tij si dhe vlerësohet nëse ky burim mund të jepet për përdorim ose jo. Sekretariati ose Agjencia mund të kërkojë oponencë për propozimin, nga organet apo institutet e specializuara, financiare dhe teknike, si dhe nga Këshilli Konsultativ Teknik i ngritur pranë tij/saj.

Në rastet kur vlerësohet se burimi mund të jepet për përdorim, kërkohet nga KKU-ja ose KBU-ja “miratimi në parim”. Nga Autoritetet e Ujit, gjykohet nëse do t'i nënshtrohet ose jo procedurave të konkursit. Pas kësaj, për rastet kur gjykohet se do të konkurohet, veprohet si në paragrafin A “Procedurat për propozimet e kërkuara.”

Në rast se fillohet procedura e konkurimit dhe nuk paraqitet asnjë subjekt tjetër i interesuar, vazhdohet procedura me subjektin që ka paraqitur ofertën.

V. Për kërkesat e paraqitura për përdorimin e ujit për,

- a) për furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë, nga ndërmarrjet (ose shatë) e ujësjellësave.
- b) për ujitje, nga federatat a shoqatat e përdoruesve të ujit.
- c) për hidroenergji (për H/C ekzistuese)

lidhet kontratë koncesionare, ndërmjet autoriteteve të ujit dhe:

- përfaqësuesit të pushtetit vendor që zotëron asetet e ndërmarrjes së ujësjellësit ose sh.a, për rastet e pikës V/a.
- përfaqësuesve të federatave dhe shoqatave të përdoruesve të ujit, për rastet e pikës V/b.
- përfaqësuesve të Koorporatës Elektroenergjitike Shqiptare ose përfaqësuesve të subjekteve juridikë që kanë aplikuar për përdorim të ujit, për rastet e pikës V/c.

Kontratat e koncesionit, për rastet e pikës V/a, V/b dhe V/c, lidhen sipas kontratave tip të miratuara nga KKKU.

VI. Organet, që kanë në përgjegjësi miratimin e kontratës së koncesionit, jepen në tabelat nr.1, nr 2, dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij vendimi (kolonat 6, 7, 8 dhe 9).

VII. Afatet brenda të cilave subjekti që ka fituar të drejtën e përdorimit të ujit duhet të fillojë veprimtarinë, janë:

- | | |
|-------------------|-----------------------------|
| - për autorizimet | 3 muaj |
| - për lejet | 2 muaj |
| - për koncesionet | afati i shënuar në kontratë |

Pas këtij afati, për lejet dhe autorizimet, subjekti humbet të drejtën e përdorimit të ujit, kurse për koncesionet, e drejta për përdorim të ujit i jepet, pas negociimeve, subjektit të klasifikuar i dyti, në listën e vlerësimit të konkursit.

VIII. Pranë Sekretariatit dhe Agjencisë, bazuar në regjimet e përdorimit të ujit, krijohen regjistra të veçantë, për:

- deklaratimet për përdorim të lirë të ujit;
- autorizimet për kërkime, studime dhe zbulime në fushën e ujit, me përjashtim të kërkimit shkencor në fushën e peshkimit dhe akuakulturës;
- lejet për përdorim uji;
- koncesionet për përdorim uji.

- IX. Të gjitha institucionet, që lidhen me fushën e përdorimit të ujit, të mos japin dhe rijapin lejet në qoftë se subjektet kërkues nuk janë të pajisur nga Autoritet e Ujit me lejen, autorizimin apo koncesionin përkatës për përdorimin e ujit.
- X. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit të propozojë në Këshillin e Ministrave projektvendimin në mbështetje të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

FATOS NANO

**KOMPETENCAT E AUTORITETEVE TË UJIT PËR
MIRATIM LEJESH DHE KONCESIONESH
(Në funksion të qëllimit të përdorimit dhe të sasisë së ujit)**

Tabelë nr. 1

Rezervë ujore për ujë të pijshëm dhe të konfeksionuar

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Njësia	Sasia		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjencia e Ujit	Sekretarati Teknik i KKU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Për pirje	l/sek	0	100						
2	Për konfeksionim	"	0	5						
3	Për pirje	"	100	2000						
4	Për konfeksionim	"	5	300						
5	Për pirje	"	> 2000							

Tabelë nr. 2

Rezervë ujore për ujitje dhe hidroenergji

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Njësia	Sasia		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjencia e Ujit	Sekretarati Teknik i KKU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ujë për ujitje dhe për hidroenergji	Mln/m ³ në vit	< = 5							
2			5	20						
3			> 20							

Tabelë nr. 3**Rezervë ujore për proces teknologjik**

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Njësia	Sasia		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjencia e Ujit	Sekretariati Teknik i KBU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ujë për proces teknologjik	l/sek	0	5						
2			5	100						
3			> 100							

Tabelë nr. 4**Rezervë ujore për eksport**

Nr.	Qëllimi i përdorimit	Njësia	Sasia		Autoriteti i ujit që miraton			Ratifikon Kuvendi	Organi ku aplikohet	
			>	< =	KBU	KKU	Këshilli i Ministrave		Agjencia e Ujit	Sekretariati Teknik i KBU
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Ujë për eksport	l/sek	0	500						
2			> 500							



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 2, datë 03.03.2005

PËR
MIRATIMIN E KONTRATËS TIP TË KONCESIONIT NDËRMJET
AUTORITETEVE TË UJIT DHE SH.A UJËSJELLËS KANALIZIMEVE
PËR PËRDORIMIN ME KONCESION TË UJIT

Në mbështetje të nenit 6, dhe 16 dhe 21 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Miratimin e Kontratës tip të Koncesionit, ndërmjet autoriteteve të ujit dhe sh.a ujësjellës kanalizimeve për përdorimin e ujit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit dhe Këshillat e Baseneve Ujëmbledhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

FATOS NANO

KONTRATË TIP KONÇESIONI
PËR PËRDORIMIN E UJIT

E lidhur sot, më datë ____/____/____,

ndërmjet

Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (Sekretariati) ose Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës (Agjencia) _____, _____, me adresë _____, përfaqësuar nga drejtori i Sekretariatit ose nga përgjegjësi i Agjencisë z. _____

dhe

Sh. a ujësjellës-kanalizime _____, e regjistruar me vendimin nr. _____, datë ____/____/____ të gjykatës së rrethit _____ me adresë _____, përfaqësuar nga z/znj. _____

ose

Ndërmarrjes së ujësjellësit _____, _____ përfaqësuar nga z/znj. _____

ose

_____ (për ujësjellësat e fshatit), përfaqësuar nga z/znj. _____

Palët bien dakort për sa më poshtë:

NENI 1
Përkufizime

Për qëllimet dhe interpretimin e kësaj Kontrate Konçesioni, do të zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

Kontrata e Konçesionit – Kjo Kontratë e hartuar në mbështetje të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Sekretariati – Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.

Agjencia – Agjencia e Ujit e Basenit Ujëmbledhës _____,
_____.

Konçesionari – Ndërmarrja ose sh.a ujësjellës-kanalizime _____,
_____, e rregjistruar në gjykatë me vendimin nr. _____, datë
___/___/_____ ose _____ (për ujësjellësat e
fshatit).

Periudhë e Konçesionit – Është periudha ndërmjet dhënies së konçesionit Konçesionarit deri në përfundimin e tij, duke përfshirë pezullimet e përkohshme dhe ndërprerjet si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Palë – Kuptohen palët e kësaj Kontrate dhe me termin “Pala” secila prej tyre.

Projekt – Studimi tekniko-ekonomik për shfrytëzimin e burimit ujqor _____, _____ të paraqitur dhe të miratuar Këshilli Kombëtar i Ujit ose nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës _____,
_____.

Forca Madhore – Konsiderohen ngjarje të Forcës madhore ngjarjet natyrore si tërmete, përmbytje, etj. si dhe çdo veprim tjetër i forcave natyrore që do të shkaktonte shterimin e burimit, ngjarjet politike të jashtëzakonshme si luftërat dhe revolucionet, grevat ose çdo lloj ndërprerje tjetër e punës dhe ndërhyrjet e palëve të treta që kanë forcë ligjore duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Kontratës që kanë të bëjnë me vullnetin e palëve dhe është jashtë kontrollit të mundshëm të tyre.

NENI 2

Objekti i Kontratës së Konçesionit dhe specifikimet

Kjo Kontratë ka për objekt dhënien për shfrytëzim, me konçesion, të burimit ujqor _____, _____.

Burimi ujqor, sipas hartës së vendosjes së burimeve, ka këto specifikime:

- Volumi i tij _____ m³ ose l/sek.
- Prurja mesatare është _____ m³ ose l/sek.
- Koordinatat e burimit:

X

Y

Z

Sasia e ujit që jepet për përdorim: _____ m³ ose l/sek.

NENI 3

E drejta e pronësisë

Pronësia mbi burimin ujq _____, _____ i takon shtetit dhe regjimi (mbi bazë konçesioni) me të cilin ai jepet në përdorim regjistrohet në regjistrin kombëtar të konçesioneve për përdorim uji.

NENI 4

Qëllimi i përdorimit

Burimi ujq _____, _____ do të përdoret vetëm për qëllime pirjeje të popullatës në _____ dhe për furnizimin me ujë të pijshëm të institucioneve _____.

NENI 5

Mënyrat e përdorimit

Uji i burimit, sipas projektit (bashkëlidhur kësaj Kontrate) të miratuar me vendimin nr. _____, datë ____/____/_____ të KRRT, pasi grumbullohet në kaptazh do të çohet në depo nëpërmjet rrjetit me tuba _____ Ø.

NENI 6

Afati i Kontratës

Kjo Kontratë Konçesioni lidhet për një afat _____ dhe është e vlefshme që nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Kontrate.

Ky afat mund të ndryshojë kur zgjidhet Kontrata për njërin prej rasteve të përcaktuara në këtë Kontratë ose në rastin kur verifikohet një ngjarje e Forcës Madhore.

NENI 7

Të Drejtat dhe Detyrimet e Konçesionarit

- Konçesionari ka të drejtë ekskluzive (për sasinë e ujit _____ l/sek që do të përdorë) të kryejë veprimtari, me bazë konçesioni, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.
- Konçesionari do të kryejë pagesat për:
 - a) shpenzimet administrative
 - b) tarifën e përdorimit të ujit me konçesion (sipas vendimit nr. 313, data 21.05.2004 të Këshillit të Ministrave).
- Tarifat do të bëhen për m³ dhe do të llogariten në bazë të sasisë faktike, të matur me matësin e ujit (kontaktorit) të vendosur në tubacionin kryesor të dërgimit të ujit në depo në dalje të kaptazhit.
- Vendosja e matësit të ujit është në ngarkim të Konçesionarit i cili në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Kontrate duhet të ketë bërë instalimet e nevojshme në prezencë të përfaqësuesve të Sekretariatit ose Agjencisë.
- Pagesat për tarifën e ujit të përdorur do të bëhen pas inspektimit në vend të matësit të ujit, nga përfaqësuesit e Sekretariatit ose Agjencisë, ku do të mbahet procesverbali përkatës për sasinë e ujit të përdorur.
- Gjatë zbatimit të Kontratës së Konçesionit, inspektimi nga përfaqësuesit e Sekretariatit ose Agjencisë do të bëhet jo më pak se çdo _____ (_____) muaj.
- Tarifat e përdorimit të ujit me konçesion, të përcaktuara nga vendimi nr. 313, datë 21.05.2004 i Këshillit të Ministrave do të kryhen nga Konçesionari në numrin e llogarisë 4302 të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, dega e thesarit, Tiranë.
- Detyrimi i Konçesionarit për të paguar tarifën pushon me përfundimin e afatit të Kontratës së Konçesionit.
- Konçesionari është i detyruar të kryejë gjithçka të nevojshme për përmbushjen e kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë.
 - Të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.
 - Të respektojë qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të ujit të përcaktuar në nenin 4 dhe 5 të kësaj Kontrate, duke mos i ndryshuar ato.

- Të përdorë nga burimi sasinë e ujit të parashikuar në këtë Kontratë.
- Të marrë masa për mbrojtjen e brigjeve të burimit uJOR.
- Të paguajë detyrimin për konçesionin (tarifën dhe shpenzimet administrative).
- Të respektojë masat mbrojtëse sipas kushteve dhe kërkesave higjieno-sanitare për evitimin e ndotjeve të ndryshme, të mbajë nën kontroll cilësinë e ujit si dhe mbrojtjen e mjedisit.
- Të mos kryejë veprime apo mosveprime që sjellin drejtpërdrejt ose si pasojë ndryshimin e formës, gjendjes dhe të kufijve të burimit.
- Të përballojë të gjitha shpenzimet për rrethimin dhe mirëmbajtjen e burimit.
- Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të shmangë dëmet ndaj pronës publike dhe private.
- Të respektojë të drejtat e pronarëve kufitarë, duke përfshirë këtu të drejtën e servitutit.
- Të mos ia kalojë apo transferojë të drejtën e përdorimit të ujit të tretëve, me përjashtim të rasteve kur Sekretariati ose Agjencia, me shkresë ia njeh të drejtën e transferimit për përdorimin e ujit një personi të tretë i cili do të lidhë kontratë me autoritetin e ujit që është palë në këtë Kontratë Konçesioni.
- Të mos pengojë Sekretariatit ose Agjencinë që të ushtrojë të drejtën e kontrollit.

NENI 8

Të drejtat dhe detyrimet e Sekretariatit ose Agjencisë

- T'i garantojë Konçesionarit ekskluzivitetin për përdorimin e burimit uJOR _____, _____ sipas qëllimit dhe mënyrës së përdorimit të parashikuar në këtë Kontratë.
- Të kontrollojë mënyrën e respektimit të Kontratës së Konçesionit dhe të projektit dhe financimit të kryer nga Konçesionari.
- Të ruajë ligjërisht pronësinë mbi mjetet kryesore të konçesionit.

NENI 9

Zgjidhja e Kontratës së Konçesionit

Palët mund të zgjidhin këtë Kontratë Konçesioni në rastet kur konstatojnë shkelje të rënda dhe të vazhdueshme të detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë të kryera nga Pala tjetër, të cilat kompromentojnë rëndë afatet dhe kushtet e përcaktuar në Projekt.

Pala e dëmtuar duhet t'ia bëjë të njohur menjëherë këto shkelje palës tjetër, e cila është e detyruar të japë një përgjigje me shkrim me argumentat përkatës, brenda 30 ditëve. Në bazë të kësaj përgjigjeje, Pala e dëmtuar mund të kërkojë ose jo zgjidhjen e Kontratës së Konçesionit sipas procedurës të përcaktuar në nenin 16 (paragrafi i tretë) të kësaj Kontrate.

NENI 10 ***Sigurimet***

Në rast se objekti i siguruar do të dëmtohet ose shkatërrohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilëve është siguruar, të ardhurat nga siguracioni do të përdoren nga Konçesionari për të riparuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen funksionuese.

NENI 11 ***Riparimi dhe mirëmbajtja***

Gjatë periudhës së konçesionit, Konçesionari do të kryejë me shpenzimet e veta të gjitha llojet e riparimeve dhe të mirëmbajtjes në objektin e Kontratës.

NENI 12 ***Kontrolli dhe Inspektimet***

Sekretariati ose Agjencia, ka të drejtë dhe detyrë të kontrollojë rregullisht objektin e konçesionit gjatë periudhës së konçesionit.

Të gjitha shkeljet e konstatuara gjatë kontrollit të përgjithshëm do t'i njoftohen me shkrim Konçesionarit sipas procedurës së parashikuar nga neni 9, paragrafi i dytë.

NENI 13 ***Legjislacioni i zbatueshëm***

Interpretimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate Konçesioni do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 14 ***Forca Madhore***

Palët nuk mund të jenë përgjegjëse në rast mospërbushjeje të detyrimeve të tyre të parashikuara nga kjo Kontratë si pasojë e ndodhjes

së njërës prej ngjarjeve të Forcës Madhore, në rastin kur Pala e dëmtuar i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet e veta.

Në rast se një detyrim i parashikuar në këtë Kontratë vonohet ose bëhet i pamundur si rezultat i Forcës Madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim Palën tjetër, duke i treguar dhe arsyetuar motivet e vonesës ose të pamundësisë si dhe masat e marra për të parandaluar dhe evituar pasojat.

Periudha e ndërprerjes dhe shtyrja e afateve të parashikuara për përmbushjen e detyrimeve përkatëse, do të konfirmohen nga Palët në një proçesverbal për ngjarjen .

NENI 15 ***Hyrja në fuqi***

Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi me nënshkrimin e saj nga Palët dhe pasi të jetë miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit ose Këshilli i Basenit Ujëmbledhës _____, _____, në përputhje me legjislacionin në fuqi për rezervat ujore.

NENI 16 ***Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve***

Problemet ose mosmarrëveshjet e krijuara midis Palëve, në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate, nuk do të ndërpresin apo anullojnë detyrimet e palëve sipas kësaj Kontrate.

Palët marrin përsipër në parim, të zgjidhin me mirëkuptim çdo lloj mosmarrëveshje.

Në të kundërt, për çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë si shkeljet, anulimi ose pavlefshmëria e saj, Palët kanë të drejtë t'i drejtohen organeve kompetente gjyqësore.

NENI 17 ***Sanksionet***

- Në rast se brenda 15 ditëve, nga data e inspektimit nga Sekretariati ose Agjencia, Koncesionari nuk paguan tarifën e përdorimit të ujit, fillojnë penaltetet prej një afati afati 1-mujor me _____ mijë lekë gjobë

për çdo ditë vonesë. Me kalimin e këtij afati, Sekretariati ose Agjencia zgjidh në mënyrë të njëanshme Kontratën e Koncesionit.

NENI 18

Dispozita të përgjithshme

Kjo Kontratë është hartuar dhe nënshkruar në ____ (_____) origjinalë, ____ (_____) prej të cilave do të merren nga Sekretariati ose Agjencia dhe ____ (_____) kopje do të merren nga Koncesionari.

NENI 19

Bashkëpunimi midis Sekretariatit ose Agjencisë dhe Koncesionarit

Sekretariati ose Agjencia dhe Koncesionari, angazhohen të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin me qëllim zbatimin e kësaj kontrate.

Çdo shtesë dhe ndryshim të kësaj Kontrate Koncesioni, do të bëhet me mirëkuptim dhe shkrim ndërmjet Palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

_____, më ____ / ____ / _____

Palët kanë pranuar këtë Kontratë duke nënshkruar si më poshtë:

**Për Sekretariatit Teknik të Këshillit
Kombëtar të Ujit**

D R E J T O R I

ose

**Për Agjencinë e Ujit të Basenit
Ujëmbledhës** _____

PËRGJEGJËSI

**Për Koncesionarin
sh.a ujësjellës-kanalizime**

Përfaqësuesi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 3, datë 03.03.2005

PËR
MIRATIMIN E DOKUMENTACIONIT STANDART TË KONKURSIT PËR
PËRDORIMIN ME KONCESION TË UJIT

Në mbështetje të nenit 6, dhe 16 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Miratimin e dokumentacionit standart për procedurat e konkurimit për përdorimin me koncesion të ujit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit dhe Këshillat e Baseneve Ujëmbledhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

FATOS NANO

FTESË PËR OFERTË PËR PËRDORIMIN E UJIT

1. Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit ose Agjencia e Ujit e Basenit _____, me procedurën konkursi hapur/ndërkombëtar, kërkon oferta për: “Përdorimi i burimit ujor _____, të ndodhur në _____.
2. Karakteristikat kryesore të burimit janë: _____

3. Sasia e ujit që jepet për përdorim: _____ l/sek.
4. Qëllimi i përdorimit (pa e kufizuar të drejtën e subjekteve për propozime të tjera):

5. Kandidatët e interesuar mund të inspektojnë dokumentat e konkursit në zyrën e Sekretariatit Teknik të KKKU-së në Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit ose Agjencisë së Ujit të Basenit _____
6. Një kopje e plotë e dokumentave të konkursit mund të blihet nga ofertuesit e interesuar me anë të një kërkesë me shkrim drejtuar Sekretariatit Teknik të KKKU-së ose Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës _____ në zyrën e cituar më sipër dhe me pagesën e një tarife të pakthyeshme prej _____
7. Afati i tërheqjes së dokumentave të tenderit është 15/25 ditë për konkursin e hapur/ndërkombëtar që nga data e fundit e shpalljes në gazetë.
8. Ofertat duhet të shoqërohen nga dokumenta juridikë dhe tekniko-ekonomike origjinalë ose kopje të noterizuara si provë e kërkesave kualifikuese të përcaktuara në dokumentat e konkursit.
9. Ofertat do të hapen në datën _____, ora _____ në zyrën: _____

10. Përfaqësues të ofertuesve janë të ftuar të ndjekin hapjen e Ofertave.

**PËRGJEGJËSI
I AGJENCISË SË UJIT TË BASENIT**

ose

**DREJTORI
I SEKRETARIATIT TEKNIK
TË KKKU**

UDHËZIM

PËR PJESËMARRËSIT NË KONKURSIN E HAPUR/NDËRKOMBËTAR PËR PËRDORIMIN E UJIT

A. TË PËRGJITHSHME

1. Prezantimi

- 1.1 Me paraqitjen e ofertës, ofertuesi pranon në mënyrë të plotë të gjitha afatet dhe kushtet e dokumentave të konkursit dhe heq dorë nga kushtet e zbatimit të vetë ofertuesit. Çdo klauzolë në ofertë në kundërshtim me këtë nuk do të quhet ose do të çojë në refuzimin e ofertës.
- 1.2 Ofertuesit duhet të ekzaminonjë me kujdes dhe të respektojnë të gjitha format, kushtet, specifikimet dhe kërkesat e përfshira në dokumentat e konkursit. Në rast të ndonjë mosperputhje midis ose ndërmjet pjesëve të dokumentave të konkursit, ofertuesit duhet të kërkojnë sqarim nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit (Sekretariati) ose Agjencia e Ujit e Basenit Ujëmbledhës (Agjencia).
- 1.3 Mosparaqitja e ofertës para afati të fundit për paraqitjen e ofertave do të rezultojë në refuzimin e ofertës.

2. Veprimet e Jashtëligjshme

- 2.1 Sekretariati ose Agjencia duhet të refuzojë një ofertë, në rast se kandidati që e bën atë jep ose premtun të japë drejtpërdrejt ose tërthorazi, çdo zyrtari të tanishëm apo të mëparshëm ose nëpunësi të Sekretariatit ose Agjencisë, një shpërblim në çfarëdo forme, një punësim ose çdo shërbim apo vleftë, si stimul për një akt, vendim ose procedure që do të ndërmarrë Sekretariati ose Agjencia.

3. Konflikt Interesi

- 3.1 Një ofertues nuk duhet të ketë konflikt interesi. Çdo ofertues që zbulohet të ketë konflikt interesi do të skualifikohet.
- 3.2 Anetaret e komisionit të vlerësimit të ofertave nuk duhet të kenë lidhje pune, gjaku ose interesash me asnjë ofertues.

4. Kualifikimi i Ofertave

- 4.1 Një person juridik do të skualifikohet nga procedura e konkurimit nëse ai nuk plotëson kërkesat për kualifikim dhe nuk paraqet dokumentacionin e kërkuar si provë të kualifikimeve të tij të përshkruara në kërkesat për kualifikim.
- 4.2 Kërkesat e kualifikimit do të zbatohen në mënyrë të barabartë për të gjithë kandidatët.
- 4.3 Sekretariati ose Agjencia duhet të skualifikojë një kandidat, i cili për kualifikimin e tij paraqet një dokument që përmban informacion të rremë.
- 4.4 Sekretariati ose Agjencia duhet të skualifikojë një kandidat, nëse konstaton në çdo kohë deri në nënshkrimin e kontratës, që informacionet e paraqitura lidhur me kualifikimin ose të dhënat që kanë lidhje me vlerësimin e kandidatit, janë të pasakta ose jo të plota.

B. PËRBËRJA E DOKUMENTAVE TË KONKURSIT

5. Pjesët e Dokumentave të Konkursit

- 5.1 Dokumentat e konkursit përbëhen nga dokumentacioni i kualifikimit dhe dokumentacioni tekniko-ekonomik, plus çdo dokumentacion ose të dhëna të tjera që mund t'u kërkojë Sekretariati ose Agjencia kur e sheh të nevojshme.
- Ftesa për ofertë
 - Udhëzimi për pjesëmarrësit në konkurs (ofertuesit)
 - Formulari i Aplikimit për Koncesion dhe Formulari “C”, të miratuar nga Këshilli Kombëtar i Ujit (dokumentacioni juridik dhe dokumentacioni tekniko – ekonomik)
 - Kontrata tip me kusht dhe Kontrata tip e koncesionit, të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Ujit
 - Vendimi nr. 313, datë 21.05.2004 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e tarifave të përdorimit të ujit” (fotokopje)

C. PËRGATITJA E OFERTAVE

6. Gjuha

- 6.1 Oferta do të shkruhet në gjuhën shqipe.

7. Monedha

- 7.1 Çmimet të shprehen në monedhën Lek.

8. Përbërja e Ofertes

- 8.1 Oferta e përgatitur dhe e paraqitur nga ofertuesi do të firmoset nga ofertuesi dhe do të përfshijë dokumentat e mëposhtme:
- Formularin e Aplikimit për Koncesion (i miratuar nga KKU)
 - Dokumentacionin juridik (sipas formularit “C” të miratuar nga KKU)
 - Dokumentacioni tekniko-ekonomik (sipas formularit “C” të miratuar nga KKU)
 - Autorizim me shkrim për perfaqësim të ofertuesit
 - Dokumentacion ose të dhëna të tjera (nëse i është kërkuar nga Sekretariati ose Agjencia)

D. PARAQITJA DHE HAPJA E OFERTAVE

9. Paraqitja e Ofertave

- 9.1 Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar duhet të paraqiten në afatin dhe vendin e caktuar, sipas të dhënave të shprehura në Ftesën për Ofertë.
- 9.2 Ofertat e marra në një datë ose orë më të vonë se ajo e specifikuar do të refuzohen dhe i kthehen ofertuesit të pahapura.

- 9.3 Vetëm një oferte mund të paraqitet nga çdo ofertues.
- 9.4 Asnjë ofertues nuk mund të marrë pjesë në ofertën e dikujt tjetër për të njëjtën kontratë në çfarëdo lloj kapaciteti.

10. Vulosja dhe Shënimi i Zarfave

- 10.1 Oferta do të futet në një zarf të madh të vulosur, firmosur dhe mbyllur nga ofertuesi.
- 10.2 Brenda zarfit që përmban ofertën, do të jenë dy zarfat e vecante të shënuar sakte. Njeri do të përmbajë formularin e aplikimit dhe dokumentacionin juridik kurse zarfi tjetër do të përmbajë dokumentacionin teknik dhe ekonomik-financiar). I gjithë dokumentacioni i kërkuar do të dorëzohet në origjinale dhe/ose të noterizuara.

11. Ndryshime/plotësime para paraqitjes së Ofertës

- 11.1 Nëse Sekretariati ose Agjencia sheh të domosdoshëm ndonjë ndryshim apo plotësim dokumentacioni, kjo duhet t'u komunikohet ofertuesve brenda një periudhe të mjaftueshme (jo më vonë se një e treta e ditëve për përgatitjen e dokumentacionit të propozimit).

12. Hapja e Ofertave

- 12.1 Sekretariati ose Agjencia do të hapë të gjitha ofertat në datën dhe orën e përcaktuar në të dhënat e shprehura në Ftesën për Ofertë.
- 12.2 Ofertuesit ose përfaqësuesit e tyre të autorizuar do të lejohen të ndjekin hapjen e ofertave.
- 12.3 Do të mbahet procesverbali përkatës dhe në bazë të kërkesës çdo ofertuesi duhet t'i vihet në dispozicion një kopje e këtij procesverbali.

13. Kontraktimi

- 13.1 Duhet patur parasysh se, në kontratën tip me kusht dhe në kontratën tip të koncesionit janë parashikuar kushtet e përgjithshme me të domosdoshme për lidhjen e këtyre kontratave. Por, sipas rastit konkret si dhe me marrëveshje ndërmjet paleve, këtyre kontratave mund t'u shtohen edhe kushte apo dispozita të tjera të nevojshme.

KONTRATË TIP ME KUSHT
PËR PËRDORIMIN E UJIT

E lidhur sot, më datë ____/____/____,

ndërmjet

Sekretariatit Teknik të KKU-së (Sekretariati) ose Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës (Agjencia) _____, _____, me adresë, _____, përfaqësuar nga drejtori i Sekretariatit ose përgjegjësi i Agjencisë z. _____

dhe

Subjektit juridik (subjekti) “_____” _____, me seli në _____, regjistruar si person juridik me vendim nr. _____, datë ____/____/____, të gjykatës së rrethit _____, përfaqësuar nga z/znj _____

NENI 1

OBJEKTI

Sekretariati ose Agjencia e Ujit _____ dhe subjekti fitues i konkursit “_____” _____, bien dakort dhe deklarojnë se marrin përsipër të lidhin mes tyre kontratën e koncesionit, me objekt përdorimin e burimit ujor _____, sipas kërkesave dhe specifikimeve të dokumentacionit të tenderit.

NENI 2

AFATI

Afati i vlefshmërisë së kësaj kontrate me kusht është deri 3 muaj që nga data e nënshkrimit të saj.

NENI 3

DETYRIMET E SUBJEKTIT

1. Subjekti “_____” _____, fitues i konkursit të hapur/ndërkombëtar, të miratuar me vendimin nr. _____, datë ____/____/_____ të Këshillit Kombëtar të Ujit (KKU) ose Këshillit të Basenit Ujëmbledhës (KBU) _____, ka për detyrë të paraqesë:

- Garancinë bankare (ngurtësim i shumës 2% të vlerës së investimit të parashikuar në projekt);
- Vërtetimin e pronësisë (nga hipoteka apo kadastra) ose kontratën apo aktmarrëveshjen për blerjen ose marrjen me qera të truallit ku do të investohet;
- Vlerësimin e ndikimit në mjedis, aprovuar nga Ministria e Mjedisit;
- Dokumentin e aftësisë profesionale për veprimtarinë e kërkuar;

Për subjektet e huaja që shpallen fitues, përveç dokumentacionit të mësipërm, kërkohet që të kryejnë procedurat përkatëse për regjistrimin si person juridik dhe si person i tatueshëm për ushtrimin e aktivitetit në Shqipëri.

2. Të negociojë kontratën e koncesionit tip dhe të përfundojë negociimet brenda afatit të kontratës me kusht.

NENI 4

KUSHTI

(Prishja e Kontratës)

Nëse brenda 3 muajve që nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate me kusht, subjekti “_____” _____, nuk plotëson detyrimet e parashikuara në këtë kontratë dhe nëse për faj të tij nuk përfundohet projektkontrata e koncesionit (sipas kontratës së koncesionit tip), e pranueshme për të dyja palët, atëherë humbet të drejtën e marrjes së koncesionit dhe i mbahet garancia bankare për sigurimin e lidhjes së kontratës.

NENI 5

HYRJA NË FUQI DHE NËNSHKRIMI

Kjo kontratë me kusht hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët kontraktuese.

Palët, pasi u njohën me përmbajtjen e kësaj kontrate ranë dakort për nënshkrimin e saj. Kjo kontratë u hartua dhe nënshkrua në _____ (_____) origjinalë, _____ (_____) për Sekretariatit Teknik ose Agjencinë e Ujit _____, _____ (_____) për Këshillin Kombëtar të Ujit ose Këshillin e Basenit Ujëmbledhës _____ dhe _____ (_____) kopje për subjektin "_____".

_____, më ____/____/_____

**Për Sekretariatit Teknik
të KKU-së**

Për subjektin " _____ " _____

D R E J T O R I

PËRFAQËSUESI

ose

Për Agjencinë e Ujit të Basenit

PËRGJEGJËSI

KONTRATË TIP KONÇESIONI PËR PËRDORIMIN E UJIT

E lidhur sot, më datë ____/____/_____,

ndërmjet

Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit (Sekretariati) ose Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës (Agjencia) _____, _____, me adresë _____, përfaqësuar nga drejtori i Sekretariatit ose përgjegjësi i Agjencisë z. _____

dhe

subjektit juridik (subjekti) “_____” _____, në vijim e quajtur Koncesionari, e regjistruar me vendimin nr. _____, datë ____/____/_____ të gjykatës së rrethit _____, me adresë _____, përfaqësuar nga z./znj. _____.

Për sa më sipër, palët bien dakort si më poshtë:

NENI 1 ***Përkufizime***

Në këtë Kontratë, termat e renditura më poshtë kanë kuptimin si vijon:

Kontrata e Konçesionit – Kjo Kontratë, e hartuar në mbështetje të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore” dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

Sekretariati – Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.

Agjencia – Agjencia e Ujit e Basenit Ujëmbledhës _____, _____.

Konçesionari – Subjekti juridik “_____” _____, i regjistruar në gjykatën e rrethit _____, me vendimin nr. _____, datë ____/____/_____.

Afati i Konçesionit – Është afati prej ____ vjetësh nga lidhja e Kontratës, deri në përfundimin e saj, duke përfshirë pezullimet e përkohshme dhe ndërprerjet si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

Palë – Kuptohen palët e kësaj Kontrate dhe me termin “Palë” secila prej tyre.

Kontrata të tjera – Të gjitha kontratat e përfunduara për të siguruar shërbimet, pajisjet dhe gjithçka tjetër të nevojshme për realizimin e Projektit.

Projekt – Studimi tekniko – ekonomik për shfrytëzimin e burimit ujor “_____” _____, _____, i paraqitur dhe i miratuar më datë ____/____/_____ nga Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) ose Këshilli i Basenit Ujëmbledhës (KBU) _____, _____.

Lejet – Lejet, liçencat, autorizimet dhe konçesionet që Konçesionari mund të kërkojë nga autoritetet kompetente për zbatimin e plotë të Projektit si dhe për stafin e vet në bazë të ligjeve në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Ndryshim thelbësor – Do të thotë çdo rrethanë ose ndryshim i ligjit, efekti i të cilës është diskriminues ndaj:

- a) Projektit, në raport me propozime ose projekte të tjera të paraqitura, të miratuara ose në zbatim në Republikën e Shqipërisë.
- b) Konçesionarit në raport me subjekte të tjera që veprojnë sipas një konçesioni të dhënë nga Autoritetet e Ujit (KKU ose KBU) për projekte të tjera të ngjashme.

Forca Madhore – Nënkupton çdo ngjarje të jashtëzakonshme dhe të paparashikuar si prishje e rendit, luftë, greva ose çdo lloj ndërprerje tjetër e punës si dhe çdo ngjarje e barabartë apo e ngjashme me sa më sipër, që mund të ndikojë në Objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përmushjen e detyrimeve reciproke të Kontratës, që kanë të bëjnë me vullnetin e palëve dhe është jashtë kontrollit të mundshëm të tyre; katastrofat natyrore si tërmete, përmbytje, etj si dhe çdo veprim tjetër i forcave natyrore që do të shkaktonte shterimin e burimit, në një shkallë të tillë që do ta bënte atë të pashfrytëzueshëm.

NENI 2

Objekti i Kontratës së Konçesionit

NENI 6
Afati i Kontratës së Konçesionit

- Kjo Kontratë Konçesioni lidhet për një afat _____ vjet dhe është e vlefshme që nga data e hyrjes në fuqi e kësaj Kontrate.
- Ky afat mund të ndryshojë kur zgjidhet Kontrata për njërin prej rasteve të përcaktuara në këtë Kontratë ose në rastin kur verifikohet një Ngjarje e Forcës Madhore.
- Periudha e përcaktuar në këtë nen mund të rinovohet vetëm me marrëveshje të Palëve.

NENI 7
Kriteret specifike të punimeve

Përshkrimet, fazat dhe çdo kriter tjetër specifik i punimeve janë përcaktuar në Projekt.

NENI 8
Koha e fillimit të punimeve

Konçesionari do të fillojë punimet, për realizimin e Projektit, brenda _____ muaji/ve nga data në të cilën kjo Kontratë hyn në fuqi.

NENI 9
Të Drejtat dhe Detyrimet e Konçesionarit

- Konçesionari ka të drejtë ekskluzive (për sasinë e ujit _____ l/sek që do të përdorë) të kryejë veprimtari, me bazë konçesioni, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë.
 - Konçesionari do të kryejë pagesat për a) për shpenzimet administrative dhe b) tarifat e përdorimit të ujit me konçesion.
 - Tarifat do të bëhen për m³ dhe do të llogariten në bazë të sasisë faktike, të matur me matësat e ujit (kontaktorëve) të vendosur
-
-

-
-
- Detyrimi i Konçesionarit për pagimin e tarifës së përdorimit të ujit fillon që nga momenti i vënies së matësave në tubacionet e ujit që do të përdoret.
 - Pagesat për tarifën e ujit të përdorur do të bëhen pas inspektimit në vend, nga përfaqësuesit e Sekretariatit ose Agjencisë, të matësave të ujit ku do të mbahet procesverbali përkatës për sasinë e ujit të përdorur.
 - Gjatë zbatimit të Kontratës së Konçesionit, inspektimi nga përfaqësuesit e Sekretariatit ose Agjencisë _____, do të bëhet jo më pak se çdo ____ (_____) muaj.
 - Tarifën e përdorimit të ujit me konçesion, të përcaktuara nga vendimi nr. 313, datë 21.05.2004 i Këshillit të Ministrave, do të kryhen nga Konçesionari në numrin e llogarisë 4302 të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, dega e thesarit, Tiranë.
 - Detyrimi i Konçesionarit për të paguar tarifën pushon me përfundimin e afatit të Kontratës së Konçesionit.
 - Konçesionari angazhohet të kryejë gjithçka të nevojshme për realizimin e Projektit që i është dhënë me koncesion sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në këtë Kontratë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në veçanti:
 - Të respektojë të gjitha dispozitat ligjore shqiptare që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare.
 - Të realizojë Projektin me mjetet e veta financiare, deri në kufirin e shumës maksimale të treguar në Projekt.
 - Të mbledhë të gjitha dhënat dhe informacionet e nevojshme për zbatimin e Projektit.
 - Të respektojë qëllimin dhe mënyrën e përdorimit të ujit të përcaktuar në nenin 4 dhe 5 të kësaj Kontrate, duke mos i ndryshuar ato.
 - Të përdorë burimin në mënyrë sa më racionale dhe të realizojë një shkarkim të kontrolluar të tij.
 - Të marrë masa për mbrojtjen e brigjeve të burimit ujor.
 - Të respektojë masat mbrojtëse sipas kushteve dhe kërkesave higjieno-sanitare për evitimin e ndotjeve, masat mbrojtëse për mjedisin dhe të ruajë të pandryshuar cilësinë e ujit.

- Të mos kryejë veprime apo mosveprime që sjellin drejtpërdrejt ose si pasojë ndryshimin e formës, gjendjes dhe të kufijve të burimit.
 - Të përballojë të gjitha shpenzimet për rrethimin dhe mirëmbajtjen e burimit.
 - Të marrë të gjitha masat paraprake, me qëllim që të garantojë jetën e punëtorëve dhe të të tretëve, të shmangë dëmet ndaj pronës publike dhe private, të respektojë të gjitha normat në fuqi dhe dispozitat e karakterit të përgjithshëm teknik për të parandaluar çdo dëm dhe fatkeqësi në punë.
 - Të zbatojë dhe të bëjë që të zbatohen të gjitha dispozitat në fushën e punës, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të parashikuara nga legjislacioni shqiptar.
 - Të respektojë të drejtat e pronarëve kufitarë, duke përfshirë këtu edhe të drejtën e servitutit.
 - Të lidhë kontrata sigurimi që të mbulojnë të gjitha risqet e paparashikueshme.
 - Të mos ia kalojë apo transferojë të drejtën e përdorimit të ujit të tretëve, me përjashtim të rasteve kur autoriteti i ujit, me shkresë ia njej të drejtën e transferimit për përdorimin e ujit një personi të tretë, i cili do të lidhë kontratë me autoritetin e ujit që është palë në këtë Kontratë Konçesioni.
 - Të mos pengojë Sekretariatit ose Agjencinë të ushtrojnë të drejtën e kontrollit.
 - Pas mbarimit të afatit të përdorimit, ta kthejë burimin ujqor në të njëjtën gjendje që e ka marrë në dorëzim (duke llogaritur një amortizim apo konsumim të burimit ujqor, si rezultat i përdorimit normal dhe të përditshëm të tij nën prezencën e kushteve atmosferike karakterisikë për vendodhjen e burimit).
 - Të përjashtojë nga çdo lloj përgjegjësie të Sekretariatit ose Agjencisë, përsa parashikohet në këtë nen për dëmet, dëmtimet dhe të tjera që mund t'i ndodhin Konçesionarit dhe stafit të vet gjatë periudhës së konçesionit.
 - Të përballojë, me të gjitha shpenzimet, çdo shpërblim për dëme shkaktuar të tretëve.
 - Të përmbushë detyrimet e përcaktuara në këtë Kontratë.
- Vendosija e matësave të ujit është në ngarkim të Konçesionarit i cili gjithashtu në datën e inspektimit nga Sekretariati ose Agjencia, duhet të kryejë edhe instalimet e nevojshme në prezencë të përfaqësuesve të Sekretariatit ose Agjencisë. Shpenzimet për blerjen dhe instalimin e matësavë të ujit do të përballohen nga Konçesionari.

- Koncesionari brenda 15 ditëve nga përfundimi i veprës së objektit, duhet të njoftojë Sekretariatit ose Agjencinë që ky/kjo i/e fundit të kryejë inspektimin përfundimtar të veprës ujore.

NENI 10

Të drejtat dhe detyrimet e Sekretariatit ose Agjencisë

- T'i garantojë Koncesionarit ekskluzivitetin për realizimin e projektit, për përdorimin e burimit ujor (_____ l/sek), sipas qëllimit dhe mënyrës së përdorimit të përcaktuar në këtë Kontratë.
- Të vërë në dispozicion të Koncesionarit, Objektin e Kontratës (burimin ujor) në gjendjen në të cilën ndodhet.
- Të mos bëjë asnjë ndryshim thelbësor.
- Ka të drejtë dhe detyrë të kontrollojë rregullisht ecurinë e Kontratës së Koncesionit sipas kushteve të miratuara në të.
- Të ruajë ligjërisht pronësinë mbi mjetet kryesore të koncesionit.
- Të mos lejojë ndërhyrje apo punime në zonat mbi ose përreth burimit të cilat do të ndikojnë në ndryshimin e parametrave ose ndotje të burimit.

NENI 11

Vlerësimi i Investimit

Investimi total i Koncesionarit do të jetë aq sa është përcaktuar në Projekt. Vlerësimi mund të jetë objekt i ndryshimeve që rrjedhin nga ngjarje të ndodhura pas miratimit të Projektit dhe nga mundësia e nevoja për të përmirësuar efektshmërinë e Projektit, gjithmonë me marrëveshje ndërmjet Palëve.

NENI 12

Programi i punimeve

Palët angazhohen të respektojnë programin e punimeve siç është përcaktuar në Projekt.

Koncesionari garanton të përfundojë investimin brenda _____ muajve nga data e fillimit të punimeve.

Këto afate mund të ndryshojnë me marrëveshje ndërmjet palëve.

NENI 13

Zgjidhja e Kontratës së Koncesionit

Palët mund të zgjidhin këtë Kontratë Konçesioni në rastet kur konstatojnë shkelje të rënda dhe të vazhdueshme të detyrimeve të parashikuara në këtë Kontratë të kryera nga Pala tjetër, të cilat kompromentojnë rëndë afatet dhe kushtet e përcaktuar në Projekt.

Pala e dëmtuar duhet t'ia bëjë të njohur menjëherë pas konstatimit, këto shkelje Palës tjetër, e cila është e detyruar të japë një përgjigje me shkrim (me argumentat përkatës), brenda 30 ditëve. Në bazë të kësaj përgjigjeje, Pala e dëmtuar mund të kërkojë ose jo zgjidhjen e Kontratës së Konçesionit sipas procedurës të përcaktuar në nenin 21 të kësaj Kontrate.

Zgjidhja e Kontratës do të bëhet në rastet kur Konçesionari është deklaruar i falimentuar, i paaftë për pagimin e tarifës për përdorimin e burimit ujor ose kur është në likujdim.

Zgjidhja e Kontratës do të bëhet edhe për raste të tjera për të cilat Palët bien dakort.

NENI 14 ***Kontrata të tjera***

Konçesionari ka të drejtë të lidhë kontrata të tjera për realizimin e Projektit. Në të gjitha kontratat e nënsipërmarrjes dhe /ose furnizimit, Konçesionari angazhohet të respektojë dispozitat e kësaj Kontrate Konçesioni. Pavarësisht nga kontratat e nënsipërmarrjes, përgjegjës para Sekretariatit ose Agjencisë për zbatimin e rregullt të kontratave, mbetet gjithmonë Konçesionari.

Përveç të drejtave dhe detyrimeve që i jepen në këtë Kontratë, Sekretariati ose Agjencia, nuk ka asnjë detyrim dhe përgjegjësi kundrejt të tretëve që lidhen me Konçesionarin dhe me këtë Kontratë.

NENI 15 ***Sigurimet***

Konçesionari do të sigurojë me shpenzimet e veta, për gjithë periudhën e konçesionit, Objektin e kësaj Kontrate si dhe punimet e lidhura që i përkasin Projektit.

Konçesionari do t'i japë Sekretariatit ose Agjencisë, me kërkesën e kësaj të fundit të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që ka të bëjë me llojet e sigurimeve të bëra.

Në rast se objekti i siguruar do të dëmtohet ose shkatërrohet për shkak të rreziqeve ndaj të cilëve është siguruar, të ardhurat nga siguracioni do të përdoren nga Konçesionari për të riparuar dhe për të rikthyer Objektin në gjendjen funksionuese e në përputhje me Projektin.

NENI 16

Riparimi dhe mirëmbajtja

Gjatë periudhës së konçesionit, Konçesionari do të kryejë me shpenzimet e veta të gjitha llojet e riparimeve dhe të mirëmbajtjes në Objektin e Kontratës.

NENI 17

Kontrolli dhe Inspektimet

Sekretariati ose Agjencia, ka të drejtë të kontrollojë rregullisht Objektin e konçesionit gjatë periudhës së konçesionit me qëllim verifikimin e ecurisë së punimeve sipas programit të përgjithshëm të realizimit të Projektit. Koncesionari dhe Sekretariati ose Agjencia duhet të gjejnë mënyrën e përshtatshme të kontrollit, duke qënë dakord që kontrollet nga Sekretariati ose Agjencia, nuk do të përbëjnë ndërhyrje të paarsyeshme në zbatimin e Projektit.

Sekretariati ose Agjencia, e realizon kontrollin nëpërmjet të autorizuarve të tij sipas afateve dhe mënyrave të rena dakort me Konçesionarin.

Koncesionari, më kërkesë me shkrim nga ana e Sekretariatit ose Agjencisë, duhet të japë të gjitha sqarimet teknike të nevojshme për të përcaktuar gjendjen e punimeve.

Të gjitha shkeljet e konstatuara nga Sekretariati ose Agjencia, gjatë kontrollit të përgjithshëm, do t'i njoftohen me shkrim Konçesionarit sipas procedurës së parashikuar nga neni 13, paragrafi i dytë.

NENI 18

Legjislacioni i zbatueshëm

Interpretimi dhe zbatimi i kësaj Kontrate Konçesionari do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

NENI 19 ***Forca Madhore***

Palët nuk mund të jenë përgjegjëse në rast mospërbushjeje të detyrimeve të tyre të parashikuara nga kjo Kontratë si pasojë e ndodhjes së njërës prej ngjarjeve të Forcës Madhore, në rastin kur Pala e dëmtuar i ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të përmbushur detyrimet e veta.

Në rast se një detyrim i parashikuar në këtë Kontratë vonohet ose bëhet i pamundur si rezultat i Forcës Madhore, Pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim Palën tjetër, duke i treguar dhe arsyetuar motivet e vonesës ose të pamundësisë si dhe masat e marra për të parandaluar dhe evituar pasojat.

Periudha e ndërprerjes dhe shtyrja e afateve të parashikuara për përmbushjen e detyrimeve përkatëse, do të konfirmohen nga Palët në një procesverbal për ngjarjen .

Si rrjedhim i ngjarjeve të shkaktuara nga një Forcë Madhore, periudha e konçesionit do të shtyhet për një periudhë kohe që caktohet me marrëveshje ndërmjet dy Palëve.

NENI 20 ***Hyrja në fuqi***

Kjo Kontratë do të hyjë në fuqi me plotësimin e kushteve të mëposhtme:

- a) nënshkrimi i kësaj Kontrate prej Palëve, ndërmjet Sekretariatit ose Agjencisë dhe Koncesionarit.
- b) miratimi i kësaj Kontrate nga Këshilli Kombëtar i Ujit ose Këshilli i Basenit Ujëmbledhës _____, _____.
- c) ratifikimi në Parlament, për burimet ujore me rëndësi kombëtare.

NENI 21 ***Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve***

Problemet ose mosmarrëveshjet e krijuara midis Palëve, në lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate, nuk do të ndërpresin apo anullojnë detyrimet e palëve sipas kësaj Kontrate.

Palët marrin përsipër në parim, të zgjidhin me mirëkuptim çdo lloj mosmarrëveshje.

Në të kundërt, për çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë si shkeljet, anulimi ose pavlefshmëria e saj, Palët kanë të drejtë t'i drejtohen organeve kompetente gjyqësore të Republikës së Shqipërisë.

NENI 22

Sanksionet

- Në rast shkeljeje të afatit të përcaktuar në nenin 12, Konçesionari do t'i paguajë Sekretariatit ose Agjencisë, për çdo ditë vonesë penaltitetin 0.01% të vlerës së investimit.
- Në rast se brenda 15 ditëve, nga data e inspektimit nga Sekretariati ose Agjencia, Koncesionari nuk paguan tarifën e përdorimit të ujit, fillojnë penaltitetet prej një afati afati 1-mujor me _____ mijë lekë gjobë për çdo ditë vonesë. Me kalimin e këtij afati, Sekretariati ose Agjencia zgjidh në mënyrë të njëanshme Kontratën e Koncesionit.

NENI 23

Dispozita të përgjithshme

Kjo Kontratë është hartuar në gjuhën shqipe/dhe atë angleze. Për çdo problem që mund të dalë në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Kontrate do të mbizotërojë gjuha _____ duke u konsideruar si varianti ligjërish i detyrueshëm.

Kjo Kontratë është hartuar dhe nënshkruar në ____ (_____) origjinalë, ____ (_____) prej të cilave do të merren nga Sekretariati ose Agjencia dhe ____ (_____) do të merren nga Konçesionari.

NENI 24

Bashkëpunimi midis Sekretariatit ose Agjencisë dhe Konçesionarit

Sekretariati ose Agjencia dhe Konçesionari, angazhohen të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin me qëllim që të garantohet zbatimi i Projektit.

Çdo shtesë dhe ndryshim të kësaj Kontrate Konçesioni, do të bëhet me mirëkuptim dhe shkrim ndërmjet Palëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

_____, më ____ / ____ / _____

Palët kanë pranuar këtë Kontratë duke nënshkruar si më poshtë:

**Për Sekretariatit Teknik
të Këshillit Kombëtar të Ujit**

D R E J T O R I

ose

**Për Agjencinë e Ujit
të Basenit _____**

PËRGJEGJËSI

**Për Konçesionarin
subjekti “ _____ ” _____**

Përfaqësuesi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 4, datë 03.03.2005

PËR
MIRATIMIN NË PARIM TË DHËNIES PËR PËRDORIM ME KONCESION
TË BURIMEVE UJORE TË ZONËS
“UJI I FTOHTË” VLORË

Në mbështetje të nenit 6, pika ë dhe të nenit 18 të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Miratimin në parim të dhënies për përdorim me koncesion të burimeve ujore (galeri) të zonës “Uji i Ftohtë” Vlorë, ujërat e të cilëve do të përdoren për eksport për qëllime tregtare.

Specifikimet e burimeve ujore janë:

- Numrat e burimeve në hartën përkatëse janë nr. 4/1 dhe nr. 6/1
- Koordinatat e burimeve janë:

	X	Y	Z
nr. 4/1	44 76 940	43 71 375	1.5 m
nr. 6/1	44 76 590	43 71 140	1.5 m

2. Sasia e ujit që jepet për përdorim: 300 l/sek
3. Ngarkohet Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit, Drejtorja e Përgjithshme e Ujësjetës Kanalizimeve dhe bashkia Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

FATOS NANO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 5, datë 03.03.2005

PËR
DISA SHTESA E NDRYSHIME TË FORMULARËVE E MIRATUAR ME
VENDIMIN NR. 3, DATË 09.01.2003 TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË
UJIT

Në mbështetje të neneve 6 dhe 20, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, me propozim të ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet në formularët e miratuar me vendimin nr.3, datë 09.01.2003 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Mbi procedurat e dhënies dhe rinovimit të lejeve për shfrytëzimin e zhavorreve dhe rërave nga shtretërit e lumenjve”, sipas lidhjes që i bashkëngjitet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit dhe Këshillat e Baseneve Ujëmbledhës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

FATOS NANO

**FORMULAR APLIKIMI PËR LEJE SHFRYTËZIMI
MATERIALESH INERTE NGA SHTRETËRIT E
LUMENJVE**

Emri dhe adresa e aplikantit:

Tel. _____ **Fax.** _____

(Emri i subjektit aplikant, emrat e përfaqësuesve të tij sipas aktit ligjor të krijimit si person juridik.)

Specifikimi i afatit që kërkohet për lejen (max. 5 vjet):

Për prodhim natyral _____vjet

Për prodhim natyral dhe të thyer _____vjet

Specifikimi i veprimtarisë që do të kryhet në zonën që do të shfrytëzohet për materiale inerte:

- | | |
|---------------------------------------------------|------------------------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> Zhavorr për mbushje | <input type="checkbox"/> Material inerte për ndërtim |
| <input type="checkbox"/> Parafabrikate | <input type="checkbox"/> Material i thyer |
| <input type="checkbox"/> Material inert për beton | |

Specifikimi i llojit të materialit për të cilin kërkohet leja e shfrytëzimit:

A. Material natyror

- Zhavorr
 Granil
 Rërë

B Material i thyer

- Çakëll
 Rërë

Emri dhe numuri i liçensës së shoqërisë që do të bëjë shfrytëzimin dhe përpunimin e materialit zhavorr:

Emri i lumit, përroit dhe vendndodhja e saktë e pjesës së shtratit të tij që kërkohet të shfrytëzohet:

Të dhëna për sasinë e materialit që do të shfrytëzohet nga karriera
m³/ditë, m³/muaj, m³/vit

Sasia e materialit të shitur në ditë muaj vit

Sasia e materialit të mbetur stok në ditë muaj vit

- Tokë vegjetale
- Zhavorr
- Zall
- Popla

Përmirësimi i zonës së shfrytëzuar (në m²). Përshkruhen me hollësi:

- Lloji i materialit të hedhur në zonën e shfrytëzuar
- Mënyra e hapjes, shtrimit dhe ngjeshjes së materialit të hedhur

Nënshkrimi i aplikantit

(_____)

_____ më, datë ____/____/_____

Vërejtje të aplikantit (nëse ka) :

FORMULAR I KËRKESËS PËR LEJE

PËR SHFRYTËZIM MATERIALESH INERTE NGA SHTRETËRIT E LUMENJVE

Për aplikimin për *Leje për shfrytëzim materialesh inerte nga shtretërit e lumenjve* plotësohet **formulari i aplikimit** bashkëlidhur dhe dorëzohet së bashku me **dokumentacionin plotësues** që përbëhet nga:

- I. Kopje e noterizuar e **vendimit të** regjistrimit në **gjykatë** si person juridik.
- II. Kopje e noterizuar e **licensës** për aktivitetin përkatës lëshuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit (komisioni i licensave).
- III. Vërtetim nga **Gjykata** që subjekti nuk është në proces gjyqësor.
- IV. Vërtetim nga **Prokuroria**.
- V. Vërtetim nga zyra e **Përmbarimit**.
- VI. Vërtetim nga zyra e **Hipotekës**.
- VII. Kopje e çertifikatës së regjistrimit në organin tatimor + **NIPT**.
- VIII. Kopje e **Vendimit** të Këshillit të Rregullimit të Territorit për **miratimin e sheshit dhe lejes së ndërtimit** (të nyjes së fraksionimit)
- IX. Të dhëna mbi **mundësitë financiare** të aplikantit për zbatimin e projektit.
- X. **Raport gjeologo-inxhinierik** i zonës që do të shfrytëzohet, përpiluar nga një person fizik apo juridik i licensuar.
- XI. Projekti i shfrytëzimit të zonës si dhe rehabilitimit të saj.
- XII. **Oponenca** e studimit e hartuar nga institucionet që parashikon **vendimi nr. 7 datë 16.04. 2004 i Këshillit Kombëtar të Ujit**.
- XIII. Vlerësimi i ndikimit në mjedis, aprovuar nga **Ministria e Mjedisit**.
- XIV. **Miratim** për shfrytëzimin e zonës së kërkuar, nga Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit (**Instituti i Studimit të Tokave**).
- XV. **Miratim** për shfrytëzimin e zonës së kërkuar, nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit (**Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës -Kanalizimeve**).
- XVI. **Miratim** për shfrytëzimin e zonës së kërkuar, nga Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit (**Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve**).

Për aplikime të subjekteve që aktualisht ushtrojnë aktivitetin në shfrytëzimin e zhavorreve në shtretërit e lumenjve, përveç kërkesave të mësipërme duhet të dorëzojnë edhe dokumentacionin plotësues të përcaktuar më poshtë:

- 1.Kontrata me **Sigurimet Shoqërore** si dhe vërtetim nga ky institucion për shlyerjen e detyrimeve ndaj tij.
2. Vërtetim nga **Policia e Ndërtimit** që nuk ka patur shkelje teknike apo ligjore gjatë shfrytëzimit të karrierës.
- 3.Vërtetim nga **Tatim-Taksat** për shlyerje të detyrimeve financiare dhe fotokpje të mandat arkëtimeve për detyrimet financiare që mundësojnë pajisjen me leje të shfrytëzimit.
- 4.Kopjen e noteruar të Lejes minerare të dhënë nga ish Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjitike ose nga ish Këshilli i Rrethit.

Bashkëlidhur jepen sqarime mbi dokumentacionin e mësipërm.

Për informacione të mëtejshme të kontaktohet me Agjencitë e Ujit të Basenit përkatës ose me Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit , Tiranë.

Formulari i aplikimit së bashku me materialin e përgatitur **sipas sqarimeve për dokumentacionin plotësues (për formularin E)** i firmosur, duhet të dorëzohet pranë **Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës dy muaj para datës së mbledhjes së Këshillit të Basenit Ujëmbledhës.**

SQARIME PËR DOKUMENTACIONIN PLOTËSUES

(PËR FORMULARIN **E**)

Sqarime për dokumentacionin që kërkohet në pikat I-VIII.

Këto dokumente duhet të jenë origjinale dhe fotokopje të noterizuara (ku shprehet "Kopje") me afatin e vlefshmërisë ligjore jo më shumë se tre muaj nga data e paraqitjes. Ky afat ligjor është i vlefshëm edhe për datën e marrjes së vendimit për pajisjen me leje shfrytëzimi nga Këshilli i Basenit përkatës. Subjekti aplikant është përgjegjës për respektimin e këtij afati ligjor.

Vendimi i Këshillit të Rregullimit të Territorit për miratimin e sheshit të ndërtimit dhe të lejes së ndërtimit duhet të jetë për nyjen e fraksionimit dhe objektet ndihmëse.

Dokumenti i kërkuar në pikën IX

Aplikanti duhet të paraqesë një dokument bankar ku të vërtetohet se në numurin e llogarisë së subjektit është e depozituar 20% e vlerës së projektit që kërkohet të realizohet.

Ose:

Një dokument që vërteton se subjekti ka fituar të drejtën e përdorimit të nje kredie bankare me vlerë jo më pak se 50% e investimit që parashikohet në projekt.

Ose:

Një kontratë legale e subjektit me të tretët i cili garanton mbështetje financiare apo materiale për realizimin e projektit e shoqëruar kjo me të dhënat financiare të kontraktuesit e burimin e tyre.

Për subjektet që kanë ushtruar më parë aktivitet privat në të njëjtën fushë ose jo duhet të dorëzohet kopje e bilancit financiar të dy viteve të fundit të miratuara nga eksperti kontabël.

Dokumenti i kërkuar në pikën X

Raporti duhet të përmbajë:

- Hyrje
- Sipërfaqen e zonës së studjuar me kordinatat përkatëse.
- Metodikën e studimit
- Punimet e kryera
- Llogaritja e rezervave (metoda e përdorur)
- Të dhëna mbi gjeologjinë e përgjithshme të zonës që do të shfrytëzohet.

- ☒ Të dhëna mbi sasi të, cilësinë granulometrinë, peshën volumore, peshën specifike të materialit inert.
- ☒ Planimetrinë e zonës që do të shfrytëzohet në shkallë 1:5000 e cila të përfshijë brenda saj një brez me gjërësi 50m që konturon zonën e shfrytëzimit.
- ☒ Profilet gjeologo-litologjike, tërthore e gjatësore, karakteristike për zonën që shfrytëzohet. Profilet duhet të përfshijnë dhe formacionin rrënjësor, ku punimi i zbulimit të jetë futur si minimum 2m në të.

Dokumenti i kërkuar në pikën XI.

Projekti i shfrytëzimit të zonës dhe rehabilitimi i saj duhet të hartohet nga institucione ose shoqëri studimore e projektuese të licensuara në fushën e hidroteknikës dhe të përmbajë:

- ☒ Të dhëna të përgjithëshme mbi kushtet minerare e hidroteknike të shfrytëzimit.
- ☒ Kapacitetin prodhues të zonës, të llogaritur sipas rezervave të përcaktuara më parë nga të dhënat gjeologo-inxhinierike, jetgjatësinë e karjerës, bazuar në prodhimtarinë e parashikuar.
- ☒ Koha e shfrytëzimit, në vite sipas prodhimtarisë së parashikuar.
 - Regjimi ditor, mujor, vjetor i punës.

☒ Punimet e shfrytëzimit

- Formen e shfrytëzimit e ndarë në pesë vite.
- Transportin e materialit.
- Fuqinë puntore, mbrojtjen në punë sipas rregullave të sigurimit teknik.
- Efektivitetin ekonomik ku të pasqyrohen çmimet e artikujve të prodhuar sipas fraksionit dhe sasia e materialit të prodhuar.
- ☒ Pjesa grafike
 - Skemat për punimet e hapjes.
 - Skemat për punimet e shfrytëzimit.
 - Planimetria dhe profilet e zhvillimit të punimeve në vite.
- ☒ Masat për rregullimin e infrastrukturës.
- ☒ Ripërtëritja e zonës së shfrytëzuar për ta kthyer në gjendjen e mëparëshme **për çdo vit shfrytëzimi.**
 - Përcaktimi i zonës së grumbullimit të dheut vegjetal, në se zona është e mbuluar.
 - Mënyrën e ripërpunimit të materialeve të mbetura stok nëpërmjet thyrjes dhe fraksionimit të tij.

- **Azhornimin e planimetrisë së zonës së shfrytëzimit në shkallë 1:5000 për çdo vit shfrytëzimi me planimetrinë e hartuar para fillimit të shfrytëzimit.**

Dokumenti i kërkuar në pikën XII

Dosja e subjektit aplikant duhet të ketë në përbërje të saj raportin e oponencës së studimit ku të jenë pasqyruar saktë si aprovimi për vënjen në zbatim të këtij projekti ashtu edhe rekomandimet e mundëshme që subjekti duhet ti respektojë gjatë shfrytëzimit të zonës. Në mbështetje të vendimit nr. 7, datë 16.04.2004 “Për kryerjen e oponencës të studimeve të rezervave ujore” të Këshillit Kombëtar të Ujit, oponenca e studimeve duhet të kryhet pranë Institutit të Nxjerrjes dhe Përpunimit të Mineraleve ose pranë Institutit të Studimeve Teknologjisë së Ndërtimit.

Dokumenti i kërkuar në pikën XIII

Në përbërje të dosjes të subjektit aplikant duhet të jetë raporti për ndikimin që do të ketë mjedisi nga aktiviteti që parashikohet të kryhet në zonën që do të shfrytëzohet, së bashku me vlerësimin (Lejen) e Ministrisë së Mjedisit.

Dokumente të kërkuara në pikat XIV-XVI

Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit (Institutit të Studimit të Tokave) duhet të japi miratimin për projektin e shfrytëzimit të zonës i cili gjatë zbatimit të tij nuk dëmton veprat e kullim-ujitjes dhe tokat bujqësore.

Ministria e Rregullimit të Teritorit dhe Turizmit (Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës-Kanalizimeve) duhet të japi miratimin për projektin e shfrytëzimit të zonës i cili gjatë zbatimit të tij nuk dëmton veprat e ujësjellës kanalizimeve të ndërtuara si dhe ato, që sipas studimeve të planeve rregullues do të ndërtohen (stacione pompimi etj).

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit (Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve) ose Këshillat e Qarqeve (kur karrjerat janë pranë rrugëve rurale) duhet të japi miratimin për projektin e shfrytëzimit të zonës i cili gjatë zbatimit të tij nuk dëmton veprat e artit në rrugët automobilistike (ura tombino) të ndërtuara si dhe ato që do të ndërtohen .

Dokumente plotësues për subjekteve që aktualisht ushtrojnë aktivitetin në shfrytëzimin e zhavorreve në shtretërit e lumenjve,

Dokumenti i kërkuar në pikën 1

Subjekti aplikant duhet të paraqesi fotokopje të kontratës me Sigurimet Shoqërore në të cilën të jëtë numuri i punonjësve që sigurohen i barabartë më fuqinë puntore të parashikuar në studimin e paraqitur. Në rastet kur subjekti kryen njëkohësisht aktivitete të tjera duhet të deklarojë punonjësit e siguruar që marrin pjesë në aktivitetin e shfrytëzimit të materjaleve inerte.

Dokumenti i kërkuar në pikën 2

Subjekti që ka ushtruar më parë këtë aktivitet duhet të paraqesë një vërtetim nga Policia e Ndërtimit në të cilit të vërtetohet se subjekti nuk është i penalizuar nga ky organizëm.

Dokumentat e kërkuara në pikën 3

Në dosjen e subjektit duhet të paraqiten fotokopje të noterizuara ose origjinale të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve financiare ndaj shtetit e lëshuar nga degët e Tatim-Taksave, detyrimeve financiare ndaj komunave përkatëse për tokën.

Brenda 10 ditëve nga marrja e vendimit nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës përkatës i cili vendos për pajisjen e subjektit aplikant me leje të shfrytëzimit të zhavorreve dhe rërave nga shtretërit e lumenjve ky i fundit duhet të dorëzojë pranë Agjencisë së Ujit të atij baseni ujëmbledhës mandat-arkëtimet bankare që vërtetojnë arkëtimin në favor të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit:

1. Pagesën 100 000 (njëqindmijë)lekë për shpenzime administrative.
2. Pagesën ekuivalente të 1500 (njëmijë e pesëqind) frangave zvicerane për çdo km² të sipërfaqes së shfrytëzimit.
3. Pagesën rentë pasurie minerare(royalty) (2% e vlerës së materialit të shitur konsumatorit) për muajin e parë e bazuar kjo vlerë në të dhënat ekonomike të studimit të paraqitur.

Dokumenti i kërkuar në pikën 4

Subjektet që më parë kanë ushtruar aktivitet në fushën e shfrytëzimit të rërave dhe zhavorreve nga shtretërit e lumenjve dhe janë pajisur me leje minerare nga ish Ministria e Burimeve Minerare dhe Energjetike apo nga ish Këshillat e Rretheve, duhet të dorëzojnë së bashku me dokumentacionin për aplikim edhe kopjen e kësaj leje të noterizuar.

Shënim:

Kur Këshilli i Basenit Ujëmbledhës gjatë shqyrtimit të kërkesave të paraqitura konstaton kushte të njëjta të subjekteve që kanë paraqitur kërkesa për të njëjtën zonë shfrytëzimi i jepet përparësi subjektit që ka ushtruar edhe më parë këtë aktivitet dhe për nyjen e të cilit ka **leje ndërtimi** të dhënë nga Këshilli i Rregullimit të Territorit.

Në rastet kur të dhënat e shoqërive që kërkojnë të shfrytëzojnë në të njëjtën zonë shfrytëzimi, rezultojnë të njëjta, si element kualifikues do të përdoret vlera e bonusit që do të ofrojë secila shoqëri në dispozicion të shtetit. Në këtë rast autoritetet e ujit njoftojnë shoqëritë për vendin , datën dhe orën në të cilën do të paraqesin dokumentin bankar dhe vërtetimin e derdhjes 1% të vlerës së bonusit të ofruar në numurin e llogarisë përkatëse.

KJO LEJE SHFRYTËZIMI JEPET ME KËTO KUSHTE:

1. Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje.
2. Të respektohen kushtet higjeno-sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit përreth.
3. Sipërfaqja e lejuar të shfrytëzohet nga drejtuesi i lejes. Leja ndalohe të transferohet një subjekti tjetër.
4. Të mos kryhen veprime që sjellin drejtpërdrejt ose si pasojë, dëmtimin e tokave bujqësore, veprave të artit.
5. Të mos pengohet kontrolli i shfrytëzimit të zonës, për të cilën është dhënë leja, që kryhet nga Agjencitë e Ujit të Këshillave të Baseneve Ujëmbledhës, nga Sekretariati Teknik i KKKU, ose persona të autorizuar prej tyre.
6. Zotëruesi i lejes paguan 100 000 (njëqindmijë) lekë për shpenzimet administrative.
7. Subjekti që disponon këtë leje duhet të paraqesë në fund të çdo viti shfrytëzimi projektin e shfrytëzimit dhe rehabilitimit për vitin pasardhës.
8. Për shkeljen e kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa në përputhje me kreun XVI të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”.

NDRYSHIMI OSE ANULLIMI I LEJES:

Kjo leje mund të ndryshohet pjesërisht ose të anulohet plotësisht , para mbarimit të afatit të përcaktuar kur:

1. Përfituesi i lejes shkel njërin nga kushtet e parashikuara më sipër.
2. Leja anulohet kur subjekti nuk paguan detyrimet financiare dhe nuk rakordon për to me Agjencinë e Ujit përkatëse brenda një afati kohor tre muaj.
3. Organi kompetent për nxjerrjen e lejes pas azhurnimeve përkatëse lidhur me shfrytëzimin e zonës për nxjerrjen e materialit inert, konstaton shkelje për kushtet e vëna për të cilën është dhënë leja.
4. Kushtet e dhënies së lejes kanë ndryshuar.
5. Kur aktiviteti që ushtrohet, bazuar në lejen e dhënë , është shkak i ndotjes së burimit ose mjedisit.

SHËNIM: KJO LEJE SHFRYTËZIMI RINOVOHET ÇDO VIT

Për Agjencinë e Ujit

Për subjektin

**FORMULAR APLIKIMI PËR RINOVIM LEJE
SHFRYTËZIMI MATERIALESH INERTE NGA
SHTRETËRIT E LUMENJVE**

Emri dhe adresa e aplikantit:

Tel. _____ **Fax.** _____

(Emri i subjektit aplikant, emrat e përfaqësuesve të tij sipas aktit ligjor të krijimit si person juridik)

Specifikimi i afatit që kërkohet për lejen (max. 1 vit):

Për prodhim natyral _____ vjet

Për prodhim natyral dhe të thyer _____ vjet

Specifikimi i veprimtarisë që do të kryhet në zonën që do të shfrytëzohet për materiale inerte:

- | | |
|---------------------------------------------------|------------------------------------------------------|
| <input type="checkbox"/> Zhavorr për mbushje | <input type="checkbox"/> Material inerte për ndërtim |
| <input type="checkbox"/> Parafabrikate | <input type="checkbox"/> Material i thyer |
| <input type="checkbox"/> Material inert për beton | |

Specifikimi i llojit të materialit për të cilin kërkohet leja e shfrytëzimit:

A. Material natyror

- Zhavorr
 Granil
 Rërë

B Material i thyer

- Çakëll
 Rërë

Emri dhe numuri i liçensës së shoqërisë që do të bëjë shfrytëzimin dhe përpunimin e materialit zhavorr:

Të dhëna për sasinë e materialit që do të prodhohet dhe shfrytëzohet(në m³/ditë, m³/muaj, m³/vit)

Sasia e materialit të shitur në _____ ditë _____ muaj
vit

Sasia e materialit të mbetur stok në _____ ditë _____ muaj
vit

- Tokë vegjetale
- Zhavorr
- Zall
- Popla

Përmirësimi i zonës së shfrytëzuar (në m²) Përshkruhen me hollësi:

- Lloji dhe sasia e materialit të hedhur në zonën e shfrytëzuar
- Mënyra e hapjes, shtrimit dhe ngjeshjes së materialit të hedhur.
- Numuri i fidanëve të mbjellë.

Nënshkrimi i aplikantit

_____ më, datë ____/____/_____

Vërejtje të aplikantit(në se ka) :

FORMULAR I KËRKESËS PËR RINOVIM LEJE

PËR SHFRYTËZIM MATERIALESH INERTE NGA SHTRETËRIT E LUMENJVE

Për aplikimin për *Rinovim Leje për shfrytëzim materialesh inerte nga shtretërit e lumenjve* plotësohet **formulari i aplikimit** bashkëlidhur dhe dorëzohet së bashku me **dokumentacionin plotësues** që përbëhet nga:

- I. Kopje e noterizuar e **licensës** për aktivitetin përkatës lëshuar nga Ministria e rregullimit të Territorit dhe Turizmit (komisioni i licensave).
- II. Vërtetim nga **Gjykata** që subjekti nuk është në proces gjyqësor.
- III. Vërtetim nga **Prokuroria**.
- IV. Vërtetim nga zyra e **Përmbarimit**.
- V. Vërtetim nga zyra e **Hipotekës**.
- VI. Planimetri në shkallë 1:5000 ku të pasqyrohen punimet e kryera dhe ato për të cilat rinovohet leja, me koordinata, ku të jepet sipërfaqja dhe profile gjeologjike- litologjike të zonës së shfrytëzuar për vitin paraardhës dhe të pasqyrohen, punimet e shfrytëzimit të materialeve nga shtrati i lumit. Për vitin vijues të pasqyrohen sipërfaqet dhe profilet e shfrytëzimit të karrierës.
- VII. Vërtetim nga **Sigurimet Shoqërore** për shlyerjen e detyrimeve ndaj këtij institucioni për periudhën 12 mujore.
- VIII. Vërtetim nga **Policia e Ndërtimit** që nuk ka patur shkelje teknike apo ligjore gjatë shfrytëzimit të karrierës për periudhën 12 mujore.
- IX. Vërtetim nga **Tatim-Taksat** për shlyerje të detyrimeve financiare dhe fotokopje të mandat arkëtimeve për detyrimet financiare që mundësojnë pajisjen me leje të shfrytëzimit.
- X. Plan biznesi për vitin në vazhdim.

Bashkëlidhur jepen sqarime mbi dokumentacionin e mësipërm.

Për informacione të mëtejshme të kontaktohet me Agjencitë e Ujit të Baseneve përkatëse ose me Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit pranë Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe Turizmit , Tiranë.

Formulari i aplikimit së bashku me materialin e përgatitur **sipas sqarimeve për dokumentacionin plotësues (për formularin F)** i firmosur duhet të dorëzohet pranë **Agjencisë së Ujit të Basenit Ujëmbledhës dy muaj para datës së mbledhjes së Këshillit të Basenit Ujëmbledhës.**

SQARIME PËR DOKUMENTACIONIN PLOTËSUES

(PËR FORMULARIN **F**)

Dokumenti i kërkuar në pikën I-V.

Këto dokumente duhet të jenë origjinale dhe fotokopje të noterizuara (ku shprehet "KOPJE) me afatin e vlefshmërisë ligjore jo më shumë se tre muaj nga data e paraqitjes. Ky afat ligjor është i vlefshëm edhe për datën e marrjes së vendimit për pajisjen me leje shfrytëzimi nga Këshilli i Basenit përkatës. Subjekti aplikant është përgjegjës për respektimin e këtij afati ligjor.

Dokumenti i kërkuar në pikën VI.

Aplikanti duhet të paraqesë një material në përbërje të të cilit të jenë: planimetri në shkallë 1:5000 ku të pasqyrohen punimet e kryera dhe ato për të cilat rinovohet leja me koordinata, ku të jepet sipërfaqja dhe profile gjeologjike- litologjike për vitin paraardhës dhe të pasqyrohen, rehabilitimi pas shfrytëzimit të materialeve nga shtrati i lumit.

Për vitin vijues të pasqyrohen sipërfaqet dhe profilet e shfrytëzimit të karrierës, sipas studimit që ka paraqitur subjekti.

Ky material me detajimet e sipërcituara , të përgatitet nga drejtuesi teknik i subjektit juridik dhe të miratohet nga institucioni që ka hartuar studimin, agjencia rajonale e mjedisit dhe agjencia përkatëse e ujit.

Dokumenti i kërkuar në pikën VII

Subjekti aplikant duhet të paraqesi vrtetim të shlyerjes së detyrimeve ndaj Sigurimeve Shoqërore në të cilën të jetë numuri i punonjësve që sigurohen i barabartë më fuqinë puntore të parashikuar në studimin e paraqitur për periudhën 12 mujore. Në rastet kur subjekti kryen njëkohësisht aktivitete të tjera duhet të deklarojë punonjësit e siguruar që marrin pjesë në aktivitetin e shfrytëzimit të materjaleve inerte.

Dokumenti i kërkuar në pikën VIII.

Subjekti duhet të paraqesë një vërtetim nga Policia e Ndërtimit në të cilit të vërtetohet se subjekti nuk është i penalizuar nga ky organizëm për periudhën 12 mujore të ushtrimit të aktivitetit.

Dokumentat e kërkuara në pikën IX

Në dosjen e kërkesës duhet të paraqiten fotokopje të noterizuara ose origjinale të vërtetimit të shlyerjes së detyrimeve financiare të lëshuar nga degët e Tatim-Taksave, detyrimeve financiare ndaj Pushtetit Vendor.

Dokumentat e kërkuara në pikën X

Aplikanti duhet të dorëzojë një plan biznesi për vitin në vazhdim ku të pasqyrohen qartë synimet e subjektit, në drejtim të investimit shitjes e fitimit, kjo në përputhje me të dhënat tekniko- ekonomike të studimit.

Shënim:

Kur **Këshilli i Basenit Ujëmbledhës** gjatë shqyrtimit të kërkesave të paraqitura konstaton se:

- Dokumentacioni që paraqet leje- mbajtësi për t`u rinovuar përmban pasaktësi ose falsifikime teknike dhe financiare.
- Ka shkelje të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”.
- Ka shkelje të detyrimeve financiare ndaj shtetit konform legjislacionit bazë mbi të cilin e është dhënë leja.

nuk i rinovon lejen e shfrytëzimit zotëruesit të saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJËMBLEDHËS

LEJE E RINOVUAR
PËR SHFRYTËZIM MATERIALESH INERTE NË SHTRATIN E
LUMIT

Nr. _____, datë _____

A. EMRI DHE ADRESA E MARRËSIT TË LEJES: _____

Kjo leje lëshohet bazuar në nenin 20, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për Rezevat Ujore”. Qëllimi i shfrytëzimit të shtratit të lumit specifikohet në paragrafin “C” të kësaj leje.

B. OBJEKTI I LEJES DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE : Lumi _____

Baseni Ujëmbledhës _____ Qarku _____ Komuna _____
Shtrati i lumit është në pronësi shtetërore dhe zona e shfrytëzimit ka këto specifikime:

Tabela e koordinatave:

	x	y	z
Pika 1:			
Pika 2:			
Pika 3:			
Pika 4:			

Sipërfaqja e shfrytëzimit (në 1 vit) _____ km²; Volumi i materialit që do të merret (në 1 vit) _____ m³

C. AKTIVITETI PËR TË CILIN DO TË PËRDORET MATERIALI ËSHTË

D. KJO LEJE ËSHTË E VLEFSHME DERI MË DATË:
____/____/____

KRYETARI

KJO LEJE SHFRYTËZIMI JEPET ME KËTO KUSHTE:

1. Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje.
2. Të respektohen kushtet higjeno-sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit përreth.
3. Sipërfaqja e lejuar të shfrytëzohet nga drejtuesi i lejes. Leja ndalohet t'i transferohet një subjekti tjetër.
4. Të mos kryhen veprime që sjellin drejtpërdrejt ose si pasojë, dëmtimin e tokave bujqësore, veprave të artit.
5. Të mos pengohet kontrolli i shfrytëzimit të zonës, për të cilën është dhënë leja, që kryhet nga Agjencitë e Ujit të Këshillave të Baseneve Ujëmbledhës, nga Sekretariati Teknik i KKKU, ose persona të autorizuar prej tyre.
6. Zotëruesi i lejes paguan 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë për shpenzimet administrative.
7. Subjekti që disponon këtë leje duhet të paraqesë në fund të çdo viti shfrytëzimi projektin e shfrytëzimit dhe rehabilitimit për vitin pasardhës.
8. Për shkeljen e kushteve ligjore të kësaj leje do të merren masa në përputhje me kreun XVI të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 "Për rezervat ujore".

NDRYSHIMI OSE ANULLIMI I LEJES:

Kjo leje mund të ndryshohet pjesërisht ose të anulohet plotësisht , para mbarimit të afatit të përcaktuar kur:

1. Përfituesi i lejes shkel njërin nga kushtet e parashikuara më sipër.
2. Leja anulohet kur subjekti nuk paguan detyrimet financiare dhe nuk rakordon për to me Agjencinë e Ujit përkatëse brenda një afati kohor tre muaj.
3. Organi kompetent për nxjerrjen e lejes pas azhurnimeve përkatëse lidhur me shfrytëzimin e zonës për nxjerrjen e materialit inert, konstaton shkelje për kushtet e vëna për të cilën është dhënë leja.
4. Kushtet e dhënies së lejes kanë ndryshuar.
5. Kur aktiviteti që ushtrohet, bazuar në lejen e dhënë , është shkak i ndotjes së burimit ose mjedisit.

SHËNIM: KJO LEJE SHFRYTËZIMI RINOVOHET ÇDO VIT

Për Agjencinë e Ujit

Për subjektin



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 6, datë 03.03.2005

PËR
KRIJIMIN E GRUPIT TË PUNËS PËR RISHIKIMIN E LIGJIT NR. 8093,
DATË 21.03.1996 “PËR REZERVAT UJORE“, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 6, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Krijimin e grupit të punës për rishikimin e ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, i ndryshuar, në harmoni me dispozitat ligjore që kanë lidhje me fushën e rezervave ujore.
2. Grupi i punës kryesohet nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar i Ujit dhe ka në përbërje përfaqësues nga:
 - Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit
 - Ministria e Financave
 - Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit
 - Ministria e Industrisë dhe Energjitikës
 - Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit
 - Ministria e Shëndetësisë
 - Ministria e Ekonomisë
 - Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit
 - Ministria e Mjedisit
 - Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha
3. Grupi i punës mund të ftojë edhe specialistë nga Akademia e Shkencave, Shoqata e Ujësjiellës Kanalizimeve, etj.

4. Brenda 15 ditësh nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ministritë dhe KKDM të përmendura në pikën 2, të caktojnë përfaqësuesit përkatës.
5. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Ministria Financave, Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, Ministria e Industrisë dhe Energjetikës, Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministria e Mjedisit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

FATOS NANO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli Kombëtar i Ujit

VENDIM

Nr. 7, datë 03.03.2005

PËR
REGJISTRIMIN DHE KONTROLLIN E SUBJEKTEVE QË
SHFRYTËZOJNË ZHAVORRE DHE RËRA NGA SHTRETËRIT E
LUMENJVE

Në mbështetje të nenit 6, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e ministrit të Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli Kombëtar i Ujit

V E N D O S I :

1. Regjistrimi i subjekteve fizike e juridike, të njohur me vendim të gjykatës për ushtrim veprimtarie që lidhet me shfrytëzimin e zhavorreve dhe rërave nga shtretërit e lumenjve dhe përrenjve, në organet tatimore të bëhet pasi të jenë pajisur paraprakisht me leje ose autorizim nga Autoritetet e Ujit.
2. Ngarkohet Ministri i Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

FATOS NANO

